



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2025 – Numri: 187

Tiranë – E martë, 14 tetor 2025

PËRMBAJTJA

	Faqe
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 967, datë 6.10.2025	Për përcaktimin e rregullave për identifikimin, regjistrimin dhe për gjurmueshmërinë e disa kafshëve tokësore të mbajtura..... 22795
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 976, datë 7.10.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Gjermanisë 22804
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 980, datë 8.10.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Polonisë..... 22804
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 981, datë 8.10.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Holandës..... 22805
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 982, datë 8.10.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, të shfaqur në shtetin e Moldavisë..... 22806
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 983, datë 8.10.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, të shfaqur në shtetin e Lituanisë..... 22809
Urdhër i drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit nr. 163, datë 18.9.2025	Për delegim kompetence..... 22811
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 47, datë 18.9.2025	Me objekt ndreqjen e gabimit në vendimin nr. 4, datë 21.1.2025, të Gjykatës Kushtetuese, për sa i takon miratimit të shpenzimeve gjyqësore..... 22812

Vendim i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 1395, datë 9.10.2025	Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, z. Besnik Xhemal Brahimi, kandidat i listës shumemërore të Partisë Socialdemokrate, qarku Shkodër, për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 Maj 2025.....	22816
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 407/14, datë 10.10.2025	Për shpronësim, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Studim-projektim, aksi rrugor Elbasan–Lekaj, korridori 8, loti I (faza I, II, III) Elbasan–Papër”.....	22818

**URDHËR¹****Nr. 967, datë 6.10.2025****PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE
PËR IDENTIFIKIMIN, REGJISTRIMIN
DHE PËR GJURMUESHMËRINË E DISA
KAFSHËVE TOKËSORE TË MBAJTURA**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës; të pikave 1 dhe 2, të nenit 118, pikave 1 dhe 2, të nenit 120, të ligjit nr. 41, datë 26.6.2025, “Për shëndetin e kafshëve”,

URDHËROJ:**Neni 1****Qëllimi dhe fusha e zbatimit**

Ky urdhër përcakton rregulla, në lidhje me:

1. Afatet për dhënien e informacionit nga operatorët për regjistrimin e kafshëve të mbajtura të llojit gjedh, dele, dhi dhe derra në bazën e të dhënave kompjuterike.

2. Aksesin e njëtrajtshëm në të dhënat e përfshira në bazën e të dhënave kompjuterike për kafshët e mbajtura të llojit gjedh, dele, dhi dhe derra, dhe specifikimet teknike dhe rregullat operative të këtyre të dhënave kompjuterike.

3. Kushtet teknike dhe metodat për shkëmbimin e të dhënave elektronike, në lidhje me kafshët e mbajtura të llojit gjedh midis bazave të të dhënave kompjuterike të Republikës së Shqipërisë dhe njohjen e funksionalitetit të plotë të një sistemi shkëmbimi të të dhënave.

4. Specifikimet teknike, formatet dhe projektimet për mjetet e identifikimit të kafshëve të mbajtura të llojit gjedh, dele, dhi, derra, deve (*camelid*) dhe drerë (*cervid*).

5. Kërkesat teknike për mjetet e identifikimit të papagajve (*psittacidae*) të mbajtur.

6. Periudhat kohore për aplikimin e mjeteve të identifikimit të kafshëve të mbajtura të llojit gjedh, dele, dhi, derra, deve (*camelid*) dhe drerë (*cervid*) të lindur në Republikën e Shqipërisë ose pas hyrjes së këtyre kafshëve në Republikën e Shqipërisë.

7. Konfigurimi i kodit të identifikimit të kafshëve të mbajtura të llojit gjedh, dele, dhi, deve (*camelid*) dhe drerë (*cervid*).

8. Heqja, modifikimi dhe zëvendësimi i mjeteve të identifikimit të kafshëve të mbajtura të llojit gjedh, dele, dhi, derra, deve (*camelid*) dhe drerë (*cervid*), si dhe afatet për kryerjen e këtyre veprimeve.

Neni 2**Përkufizimet**

Të gjithë termat e përcaktuar në këtë urdhër kanë të njëjtin kuptim me ato të përcaktuar në nenin 2, të urdhrit nr. 611, datë 8.8.2024, “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për regjistrimin e kafshëve në bazën e të dhënave kombëtare dhe gjurmueshmëria e tyre”, duke përjashtuar përkufizimet e autoriteteve kompetente, të cilat kanë të njëjtin kuptim me ato të përcaktuar në ligjin nr. 41, datë 26.6.2025, “Për shëndetin e kafshëve”.

Neni 3**Afatet dhe procedurat për dhënien e
informacionit nga operatorët për regjistrimin e
kafshëve të mbajtura të llojit gjedh, dele, dhi
dhe derra**

1. Operatorët që mbajnë kafshë të llojit gjedh, dele, dhi dhe derra janë të detyruar të japin informacionin mbi lëvizjet, lindjet dhe ngordhjet, sipas përcaktimeve në shkronjën “ç”, të nenit 112, të ligjit nr. 41, datë 26.6.2025, “Për shëndetin e kafshëve”, si dhe informacion mbi lëvizjet e tyre sipas shkronjës “c”, të pikës 1, të nenit 113, të ligjit nr. 41, datë 26.6.2025, “Për shëndetin e kafshëve” dhe të shkronjës “b”, të nenit 20, të urdhrit nr. 611, datë 8.8.2024, “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për regjistrimin e kafshëve në bazën e të dhënave kombëtare dhe gjurmueshmëria e tyre”, lidhur me regjistrimin në bazat e të dhënave kompjuterike të ngritura për ato specie, periudha kohore për dhënien e informacionit përcaktohet nga Autoriteti Kompetent për Kontrollin Zyrtar. Koha maksimale për dhënien e informacionit nuk duhet të kalojë 7 ditë nga lëvizja, lindja ose ngordhja e kafshëve, sipas rastit.

¹ Ky urdhër është përafshuar pjesërisht me rregulloren zbatuese të Komisionit (BE) 2021/520, të datës 24 mars 2021, që përcakton rregullat për zbatimin e rregullores (BE) 2016/429, të Parlamentit

Evropian dhe të Këshillit, në lidhje me gjurmueshmërinë e disa kafshëve tokësore të mbajtura. nr. Celex 32021R0520, FZ L 104, datë 25.3.2021, f. 39–51.



2. Në rastin e lindjeve, kur përcaktohet periudha maksimale kohore për dhënien e informacionit, Autoriteti Kompetent për Kontrollin Zyrtarë përdor datën kur mjeti i identifikimit vendoset te kafsha si pikënisje e afatit përkatës, me kusht që të mos ketë rrezik për ngatërrim midis kësaj date dhe datës së lindjes së kafshës.

3. Me përjashtim të pikës 1, të këtij neni, Autoriteti Kompetent për Kontrollin Zyrtarë mund të zgjasë periudhën maksimale kohore për dhënien e informacionit mbi lëvizjet e përmendura në pikën 1 të këtij neni deri në 14 ditë, pas lëvizjeve të gjedhëve brenda Republikës së Shqipërisë nga stabilimentet e origjinës në kullotat e regjistruara të vendosura në zonat malore për kullotje. Autoriteti Kompetent për Kontrollin Zyrtarë mund të vendosë të pranojë listat e gjedhëve që i nënshtrohen lëvizjeve në stabilimentet e kullotave të regjistruara nga operatorët e atyre stabilimenteve.

Këto lista përmbajnë:

- a) numrin unik të regjistrimit të kullotës së regjistruar;
- b) kod identifikimi të kafshës;
- c) numrin unik të regjistrimit të stabilimentit/fermës së origjinës;
- ç) datën e mbërritjes së kafshëve në kullotën e regjistruar;
- d) datën e parashikuar të nisjes së kafshëve nga kullota e regjistruar.

Neni 4

Akses i njëtrajtshëm në bazat e të dhënave kompjuterike për kafshët e mbajtura të llojit gjedh, dele, dhi dhe derra

Autoriteti Kompetent për Kontrollin Zyrtarë siguron që operatorët që mbajnë gjedh, dele, dhi dhe derra kanë akses pa pagesë në databazën e kompjuterizuar, sipas kërkesës së tyre, vetëm për leximin e të dhënave që mbahen në bazat e të dhënave kompjuterike të përcaktuara nga shkronja “a” deri në “c”, të pikës 1, të nenit 109, të ligjit nr. 41, datë 26.6.2025, “Për shëndetin e kafshëve”, që lidhen me stabilimentin e tyre.

Neni 5

Specifikimet teknike për bazat e të dhënave kompjuterike për kafshët e mbajtura të llojit gjedh, dele, dhi dhe derra

1. Autoriteti Kompetent Qendror siguron që bazat e të dhënave kompjuterike për kafshët e mbajtura të llojit gjedh, dele, dhi dhe derra të përcaktuara në shkronjat “a” deri në “c”, të pikës 1, të nenit 109, të ligjit nr. 41, datë 26.6.2025, “Për shëndetin e kafshëve”, të jenë të ndërtuara në atë mënyrë që informacioni i regjistruar në këto baza të dhënash të mund të shkëmbehet midis bazave të të dhënave kompjuterike të sistemeve të tjera në vend, sipas formatit të përcaktuar në kolonën e tretë të tabelës në shtojcën I, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse të këtij urdhri.

2. Me anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian bazat e të dhënave kompjuterike për kafshët e mbajtura të llojit gjedh, dele, dhi dhe derra, të përmendura në shkronjat “a” deri në “c”, të pikës 1, të nenit 109, të ligjit nr. 41, datë 26.6.2025, “Për shëndetin e kafshëve”, të jenë të ndërtuara në mënyrë të tillë që informacioni i regjistruar në to, të mund të shkëmbehet midis bazave të të dhënave kompjuterike të shteteve anëtare, në formatin e përcaktuar në kolonën e tretë të tabelës në shtojcën I, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse të këtij urdhri.

Neni 6

Rregullat operacionale në bazat e të dhënave kompjuterike për kafshët e mbajtura të llojit gjedh, dele, dhi dhe derra

Autoriteti Kompetent për Kontrollin Zyrtarë zbaton masat e duhura teknike dhe organizative për të siguruar që bazat e të dhënave kompjuterike për kafshët e mbajtura të llojit gjedh, dele, dhi dhe derra, të përmendura në shkronjat “a” deri në “c”, të pikës 1, të nenit 109, të ligjit nr. 41, datë 26.6.2025, “Për shëndetin e kafshëve”, vazhdojnë të operojnë në rast të mosfunksionimit apo ndërprerjeve të mundshme. Këto masa garantojnë, gjithashtu, sigurinë, integritetin dhe vërtetësinë e informacionit të regjistruar në këto baza të dhënash.



Neni 7

Kushtet dhe mënyrat teknike për shkëmbimin elektronik të të dhënave të dokumenteve të identifikimit, në lidhje me kafshët e mbajtura të llojit gjedh, ndërmjet bazave të të dhënave kompjuterike me sistemet e tjera në vend dhe/ose shtete të tjera

1. Kur Autoritetet Kompetente për Kontrollat Zyrtare shkëmbejnë në mënyrë elektronike të dhëna të dokumenteve të identifikimit, në lidhje me kafshët e mbajtura të llojit gjedh me autoritete kompetente të tjera në vend ose shtete të tjera kur i kërkohet, të përmendura në shkronjat “a” deri në “c”, të nenit 8, të urdhrit nr. 611, datë 8.8.2024, “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për regjistrimin e kafshëve në bazën e të dhënave kombëtare dhe gjurmueshmëria e tyre”, këto të dhëna shkëmbehen në formatin e përkufizimit të skemës XML të vënë në dispozicion nga Autoriteti Kompetent Qendror.

2. Autoriteti Kompetent për Kontrollat Zyrtare në vendin e origjinës së gjedhëve të mbajtur, të destinuara për t’u lëvizur, siguron që të dhënat e dokumentit të identifikimit dërgohen në mënyrë elektronike në vendin e destinacionit përpara nisjes së kafshëve dhe të sigurojë përcaktimin e kohës së dërgimit të të dhënave.

Neni 8

Njohja e funksionimit të plotë të një sistemi për shkëmbimin elektronik të të dhënave të dokumenteve të identifikimit, në lidhje me kafshët e mbajtura të llojit gjedh midis bazave të të dhënave kompjuterike të Republikës së Shqipërisë dhe shteteve të tjera

1. Autoriteti Kompetent për Kontrollat Zyrtare shkëmben të dhënat e dokumenteve të identifikimit elektronik, në lidhje me kafshët e mbajtura të llojit gjedh me autoritetet kompetente të shteteve të tjera, kur i kërkohet nëpërmjet bazave të të dhënave kompjuterike.

2. Autoriteti Kompetent për Kontrollat Zyrtare harton dhe publikon në faqen e tij zyrtare listën e shteteve të tjera me të cilat ka shkëmbyer të dhëna të dokumenteve të identifikimit përmes sistemeve.

Neni 9

Specifikimet teknike, formatet dhe projektimet për mjetet e identifikimit të kafshëve të mbajtura të llojit gjedh, dele, dhi, derra, deve (*camelid*) dhe drerë (*cervid*)

1. Autoriteti Kompetent për Kontrollat Zyrtare, i cili është autoriteti përgjegjës për sigurimin dhe ndjekjen e procedurave të prokurimit publik miraton përdorimin e matrikujve konvencionalë të veshit ose llastik konvencionalë mbi kurorën e thundrës të referuar në shkronjat “a” dhe “b”, të shtojcës I, të urdhrit nr. 611, datë 8.8.2024, “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për regjistrimin e kafshëve në bazën e të dhënave kombëtare dhe gjurmueshmëria e tyre”, si mjet për identifikimin e kafshëve të mbajtura të llojit gjedh, dele, dhi, derra, deve (*camelid*) dhe drerë (*cervid*), nëse këto mjete identifikimi përmbushin specifikimet teknike të përcaktuara në pjesën 1, të shtojcës II, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse të këtij urdhri.

2. Autoriteti kompetent për Kontrollat Zyrtare, i cili është autoriteti përgjegjës për sigurimin dhe ndjekjen e procedurave të prokurimit publik miraton përdorimin e tatuazheve të përmendura në shkronjën “g”, të shtojcës I, të urdhrit nr. 611, datë 8.8.2024, “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për regjistrimin e kafshëve në bazën e të dhënave kombëtare dhe gjurmueshmëria e tyre”, si mjet për identifikimin e kafshëve të mbajtura të llojit dele, dhi, derra dhe drerë (*cervid*), vetëm nëse ato tatuazhe sigurojnë shenjëzim të pashlyeshëm dhe lexim të duhur, siç parashikohet në pikat 2 dhe 3, të nenit 10, në shkronjën “b”, të pikës 1, të nenit 16; në shkronjën “c”, të pikës 2, të nenit 37 dhe shkronjën “c”, të pikës 1, të nenit 40, të urdhrit nr. 611, datë 8.8.2024, “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për regjistrimin e kafshëve në bazën e të dhënave kombëtare dhe gjurmueshmëria e tyre”.

3. Autoriteti Kompetent për Kontrollat Zyrtare, i cili është autoriteti përgjegjës për sigurimin dhe ndjekjen e procedurave të prokurimit publik, miraton përdorimin e mjeteve identifikuese elektronike të përmendur në shkronjat “c” deri në “f”, të shtojcës I, të urdhrit nr. 611, datë 8.8.2024, “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për regjistrimin e kafshëve në bazën e të dhënave kombëtare dhe gjurmueshmëria e tyre”, si mjet për identifikimin e kafshëve të mbajtura të llojit gjedh, dele, dhi, derra, deve (*camelid*) dhe drerë (*cervid*), nëse



këto mjete identifikimi plotësojnë specifikimet teknike të përcaktuara në pjesën 2, të shtojcës II të këtij urdhri. Përveç kësaj, mjetet identifikuese elektronike të përmendur në shkronjat “c” dhe “P”, të shtojcës I, të urdhrit nr. 611, datë 8.8.2024, “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për regjistrimin e kafshëve në bazën e të dhënave kombëtare dhe gjurmueshmëria e tyre”, plotësojnë specifikimet teknike të përcaktuara në pjesën 1, të shtojcës II të këtij urdhri.

4. Me përjashtim të pikës 3 të këtij neni, Autoriteti Kompetent për Kontrollin Zyrtarë, i cili është autoriteti përgjegjës për sigurimin dhe ndjekjen e procedurave të prokurimit publik miraton përdorimin e matrikujve elektronikë të veshit, si mjete për identifikimin e kafshëve të mbajtura të llojit derra, nëse këto mjete identifikimi plotësojnë specifikimet teknike të përcaktuara nga vendi ku mbahen derrat, dhe shfaqin në mënyrë të dukshme, të lexueshme dhe të pashlyeshme të numrit unik të regjistrimit të:

- a) fermës/stabilimentit të lindjes së kafshës; ose
- b) të stabilimentit të fundit të zinxhirit të furnizimit të përmendur në nenin 17, të urdhrit nr. 611, datë 8.8.2024, “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për regjistrimin e kafshëve në bazën e të dhënave kombëtare dhe gjurmueshmëria e tyre”, kur ato kafshë zhvendosen në një stabiliment jashtë atij zinxhiri furnizimi.

Neni 10

Specifikimet teknike, formatet dhe projektimet për mjetet e identifikimit të papagajve (*psittacidae*) të mbajtur

1. Operatorët të cilët mbajnë kafshë të llojit papagaj (*psittacidae*) sigurojnë që:

- a) unaza e këmbës, e përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 1, të nenit 40, të urdhrit nr. 611, datë 8.8.2024, “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për regjistrimin e kafshëve në bazën e të dhënave kombëtare dhe gjurmueshmëria e tyre”, përmbush specifikimet teknike të përcaktuara në pjesën 1, të shtojcës II të këtij urdhri;

- b) tatuazhi i përmendur në shkronjën “c”, të pikës 1, në nenin 40, të urdhrit nr. 611, datë 8.8.2024, “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për regjistrimin e kafshëve në bazën e të dhënave kombëtare dhe gjurmueshmëria e

tyre”, siguron shenjë të dukshme të lexueshme dhe të pashlyeshme.

2. Autoriteti Kompetent për Kontrollin Zyrtarë miraton përdorimin e transponderëve injektues të përmendur në shkronjën “b”, të pikës 1, të nenit 40, të urdhrit nr. 611, datë 8.8.2024, “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për regjistrimin e kafshëve në bazën e të dhënave kombëtare dhe gjurmueshmëria e tyre”, si mjet identifikimi i kafshëve të mbajtura të llojit papagaj (*psittacidae*), nëse këto mjete identifikimi përmbushin specifikimet teknike të përcaktuara në pikën 2, të pjesës 2, të shtojcës II të këtij urdhri dhe njofton për njohje, dhe zbatim të këtij urdhri operatorët të cilët mbajnë kafshë të llojit papagaj (*psittacidae*).

Neni 11

Rregullat për miratimin e identifikuesve elektronikë të kafshëve të mbajtura të llojit gjedh, dele, dhi, derra, deve (*camelid*), drerë (*cervid*) dhe papagaj (*psittacidae*)

1. Kur jepet miratimi i identifikuesve elektronikë të përmendur në shkronjat “c” deri në “P”, të shtojcës I, të urdhrit nr. 611, datë 8.8.2024, “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për regjistrimin e kafshëve në bazën e të dhënave kombëtare dhe gjurmueshmëria e tyre”, për kafshët e mbajtura të llojit gjedh, dele, dhi, derra, deve (*camelid*), drerë (*cervid*) dhe papagaj (*psittacidae*), Autoriteti Kompetent për Kontrollin Zyrtarë siguron që prodhuesit e identifikuesve elektronikë vërtetojnë se testimi i performancës dhe përputhshmërisë, të referuar në pikën 4, të pjesës 2, të shtojcës II, të këtij urdhri është kryer në qendra për testimet të akredituara me standardin ISO/IEC 17025, “Kërkesat e përgjithshme për kompetencën e laboratorëve të testimit dhe kalibrimit”.

2. Kur jepet miratimi i identifikuesve elektronikë, të përmendur në pikën 1 të këtij neni, Autoriteti Kompetent për Kontrollin Zyrtarë mund të kërkojë që prodhuesit e identifikuesve elektronikë të kryejnë teste shtesë për qëndrueshmërinë për të siguruar funksionalitetin e tyre në kushtet specifike gjeografike ose klimatike të vendit në fjalë, në përputhje me standardet e përcaktuara nga Autoriteti Kompetent për Kontrollin Zyrtarë.



Neni 12

Konfigurimi i kodit të identifikimit të kafshëve të mbajtura të llojit gjedh, dele, dhi, deve (*camelid*) dhe drerë (*cervid*)

Kodi i identifikimit të kafshëve të mbajtura të llojit gjedh, dele, dhi, deve (*camelid*) dhe drerë (*cervid*) përmban këto elemente:

1. Kodi i vendit ku kryhet aplikimi fillestar për mjetet e identifikimit për kafshët, në formatin:

a) kodi me dy shkronja, në përputhje me standardin ISO 3166-1 alfa-2;

b) kodi treshifror i vendit, në përputhje me standardet numerike ISO 3166-1;

2. Elementi i dytë i kodit të identifikimit është një kod unik për çdo kafshë, që nuk i kalon 12 karaktere numerike.

Neni 13

Periudhat kohore për aplikimin e mjeteve të identifikimit të kafshëve të mbajtura të llojit gjedh

1. Operatorët sigurojnë që mjetet e identifikimit të përmendura në shkronjën “a”, të nenit 112, të ligjit nr. 41, datë 26.6.2025, “Për shëndetin e kafshëve”, aplikohen për kafshët e mbajtura të llojit gjedh përpara tejkallimit të një periudhe maksimale kohore pas lindjes, që përcaktohet nga Autoriteti Kompetent për Kontrollin Zyrtar në të cilin kanë lindur kafshët. Periudha maksimale kohore llogaritet nga data e lindjes së kafshëve dhe nuk kalon 20 ditë.

2. Me përjashtim të pikës 1 të këtij neni, Autoriteti Kompetent për Kontrollin Zyrtar autorizon operatorët të zgjasin periudhën maksimale kohore për aplikimin e një mjeti të dytë identifikimi deri në 60 ditë, pas datës së lindjes së kafshëve, për arsye që lidhen me zhvillimin fiziologjik të kafshëve, nëse mjeti i dytë i identifikimit është një bolus ruminal.

3. Me përjashtim të pikës 1 të këtij neni, Autoriteti Kompetent për Kontrollin Zyrtar mund të autorizojë operatorët të zgjasin periudhën maksimale kohore deri në 9 muaj, në kushtet e mëposhtme:

a) Kur kafshët janë:

i. të rritura në kushte ekstensive, me viça që qëndrojnë me nënat e tyre;

ii. nuk kanë kontakt të rregullt me njerëzit;

b) mbajtur në zona të cilat sigurojnë një shkallë të lartë të izolimit të tyre;

c) në një shtrirje/ekstension që nuk pengon gjurmueshmërinë e tyre.

2. Autoriteti Kompetent për Kontrollin Zyrtar mund të kufizojë autorizimin e përmendur në shkronjën “a”, të pikës 3 të këtij neni në zona të veçanta gjeografike, specie ose raca specifike të kafshëve të mbajtura të llojit gjedh.

3. Operatorët sigurojnë që asnjë kafshë e mbajtur e llojit gjedh nuk largohet nga stabilimenti i lindjes, përveç rasteve kur për ato kafshë kanë aplikuar mjetet e identifikimit të përmendura në shkronjën “a”, të nenit 112, të ligjit nr. 41, datë 26.6.2025, “Për shëndetin e kafshëve”.

Neni 14

Periudhat kohore për aplikimin e mjeteve të identifikimit të kafshëve të mbajtura të llojit dele dhe dhi

1. Operatorët sigurojnë që mjetet e identifikimit të përmendura në shkronjën “a”, të pikës 1, të nenit 113, të ligjit nr. 41, datë 26.6.2025, “Për shëndetin e kafshëve”, aplikohen për kafshët e mbajtura të llojit dele dhe dhi përpara tejkallimit të një periudhe maksimale kohore pas lindjes, që do të përcaktohet nga Autoriteti Kompetent për Kontrollin Zyrtar në të cilin kanë lindur kafshët. Periudha kohore maksimale llogaritet nga data e lindjes së kafshëve dhe nuk duhet të kalojë 9 muaj.

2. Operatorët sigurojnë që asnjë kafshë e mbajtur e llojit dele ose dhi nuk largohet nga stabilimenti i lindjes, përveç rasteve kur për ato kafshë janë aplikuar mjetet e identifikimit të përmendura në germën “a”, të pikës 1, të nenit 113, të ligjit nr. 41, datë 26.6.2025, “Për shëndetin e kafshëve”.

Neni 15

Periudhat kohore për aplikimin e mjeteve të identifikimit të kafshëve të mbajtura të llojit derra

1. Operatorët sigurojnë që mjetet e identifikimit të përmendura në shkronjën “a”, të nenit 115, të ligjit nr. 41, datë 26.6.2025, “Për shëndetin e kafshëve”, aplikohen për kafshët e mbajtura të llojit derra para tejkallimit të një periudhe maksimale kohore pas lindjes, që përcaktohet nga Autoriteti



Kompetent për Kontrollat Zyrtare në të cilin kanë lindur kafshët. Periudha kohore maksimale llogaritet nga data e lindjes së kafshëve dhe nuk duhet të kalojë 9 muaj.

2. Operatorët sigurojnë që kafshët e mbajtura të llojit derra nuk largohen nga stabilimenti i lindjes ose dalin nga zinxhiri i furnizimit, përveç rasteve kur për ato kafshë janë aplikuar mjetet e identifikimit të përmendura në germën “a”, të nenit 115, të ligjit nr. 41, datë 26.6.2025, “Për shëndetin e kafshëve”.

Neni 16

Periudhat kohore për aplikimin e mjeteve të identifikimit të kafshëve të mbajtura të llojit deve (*camelid*) dhe drerë (*cervid*)

1. Operatorët sigurojnë që mjetet e identifikimit të përmendura në pikat 1 dhe 2, të nenit 37, të urdhrit nr. 611, datë 8.8.2024, “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për regjistrimin e kafshëve në bazën e të dhënave kombëtare dhe gjurmueshmëria e tyre”, aplikohen për kafshët e mbajtura të llojit deve (*camelid*) dhe drerë (*cervid*) përpara skadimit të një periudhe maksimale kohore pas lindjes, që përcaktohet nga Autoriteti Kompetent për Kontrollat Zyrtare në të cilin kanë lindur kafshët. Periudha kohore maksimale llogaritet nga data e lindjes së kafshëve dhe nuk duhet të kalojë 9 muaj.

2. Operatorët sigurojnë që asnjë kafshë e mbajtur e llojit deve (*camelid*) ose drerë (*cervid*) nuk largohet nga stabilimenti i lindjes ose stabilimenti i parë i destinacionit nëse ato kafshë janë zhvendosur në atë stabiliment nga habitat i ku kanë qëndruar si kafshë të egra, përveç rasteve kur për ato kafshë janë aplikuar mjetet e identifikimit të përmendura në pikat 1 dhe 2, të nenit 37, të urdhrit nr. 611, datë 8.8.2024, “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për regjistrimin e kafshëve në bazën e të dhënave kombëtare dhe gjurmueshmëria e tyre”.

3. Autoriteti Kompetent për Kontrollat Zyrtare përjashton operatorët që mbajnë kafshë të llojit drerë (*reindeer*) nga kërkesat në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, me kusht që përjashtimi nuk rrezikon gjurmueshmërinë e kafshëve.

4. Me përjashtim të pikës 1 të këtij neni, Autoriteti Kompetent për Kontrollat Zyrtare mund të përjashtojë operatorët që mbajnë kafshë të llojit drerë (*cervid*) nga kërkesat e pikës 1, në këto raste:

- a) kur kafshët janë rritur:

- i. në kushte ekstensive;
- ii. pa kontakt të rregullt me njerëzit;
- b) zona ku kafshët janë mbajtur, siguron një shkallë të lartë të izolimit të kafshëve;
- c) ky përjashtim nuk pengon gjurmueshmërinë e kafshëve.

Neni 17

Periudhat kohore për aplikimin e mjeteve të identifikimit në kafshët e mbajtura të llojit gjedh, dele, dhi, derra, deve (*camelid*) dhe drerë (*cervid*) pas hyrjes së tyre në Republikën e Shqipërisë

1. Pas hyrjes në Republikën e Shqipërisë kafshët e mbajtura të llojit gjedh, dele, dhi, derra, deve (*camelid*) dhe drerë (*cervid*) dhe ku ato kafshët mbeten në vend, operatorët sigurojnë që mjetet e identifikimit të përmendura në nenin 45, të urdhrit nr. 611, datë 8.8.2024, “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për regjistrimin e kafshëve në bazën e të dhënave kombëtare dhe gjurmueshmëria e tyre”, aplikohen brenda 20 ditëve pas mbërritjes së tyre në stabilimentin e parë të mbërritjes.

2. Me përjashtim të pikës 1 të këtij neni, Autoriteti Kompetent për Kontrollat Zyrtare i mbërritjes së parë autorizon operatorët të zgjasin periudhën kohore maksimale për aplikimin e një mjeti të dytë identifikimi deri në 60 ditë, pas datës së lindjes së kafshëve, për arsye që lidhen me zhvillimin fiziologjik të kafshëve, nëse mjeti i dytë i identifikimit është një bolus ruminal.

3. Operatorët sigurojnë që asnjë kafshë e mbajtur e llojit gjedh, dele, dhi, derra, deve (*camelid*) ose drerë (*cervid*) nuk largohet nga stabilimenti i parë i arritjes, përveç rasteve kur për ato kafshë janë aplikuar mjetet e identifikimit të përmendura në nenin 45, të urdhrit nr. 611, datë 8.8.2024, “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për regjistrimin e kafshëve në bazën e të dhënave kombëtare dhe gjurmueshmëria e tyre”.

Neni 18

Heqja dhe modifikimi i mjeteve të identifikimit të kafshëve të mbajtura të llojit gjedh, dele, dhi, derra, deve (*camelid*) dhe drerë (*cervid*)

Autoriteti Kompetent për Kontrollat Zyrtare autorizon operatorët për heqjen ose modifikimin



e mjeteve të identifikimit të kafshëve të mbajtura të llojit gjedh, dele, dhi, derra, deve (*camelid*) dhe drerë (*cervid*) nëse largimi ose modifikimi nuk rrezikon gjurmueshmërinë e kafshëve, duke përfshirë gjurmueshmërinë e stabilimentit në të cilën kanë lindur dhe nëse është e aplikueshme, identifikimi individual i kafshëve të mbetet i mundur.

Neni 19

Zëvendësimi i mjeteve të identifikimit të kafshëve të mbajtura të llojit gjedh, dele, dhi, derra, deve (*camelid*) dhe drerë (*cervid*) dhe afatet për veprime të tilla

1. Autoriteti Kompetent për Kontrolllet Zyrtare mund të autorizojë operatorët të zëvendësojnë mjetet e identifikimit të kafshëve të mbajtura të llojit gjedh, dele, dhi, derra, deve (*camelid*) dhe drerë (*cervid*) nëse zëvendësimi nuk rrezikon gjurmueshmërinë e kafshëve, duke përfshirë gjurmueshmërinë e stabilimentit në të cilën kanë lindur dhe nëse është e aplikueshme, identifikimi individual i kafshëve të mbetet i mundur.

2. Zëvendësimi i përmendur në pikën 1, të këtij neni, autorizohet në këto raste:

a) ku kafshët janë identifikuar me dy mjetet identifikimi dhe një nga ato mjetet identifikimi është bërë i palexueshëm ose ka humbur, me kusht që kodi i identifikimit të kafshëve të mbetet i pandryshuar dhe të vazhdojë të përputhet me kodin në mjetet e mbetura të identifikimit;

b) ku kafshët janë identifikuar me një ose dy mjetet identifikimi që shfaqin kodin e identifikimit të kafshëve dhe ato mjetet identifikimi janë bërë të palexueshme ose kanë humbur, me kusht që të mbetet i mundur përcaktimi i kodit të identifikimit të kafshëve me siguri të arsyeshme dhe kodi i identifikimit të kafshëve të mbetet i pandryshuar;

c) ku kafshët e mbajtura të llojit dele, dhi ose derra janë identifikuar me një mjet identifikimi që tregon numrin unik të regjistrimit të një stabilimenti dhe mjeti i identifikimit është bërë i palexueshëm ose ka humbur, me kusht që të jetë ende e mundur të përcaktohet me një siguri të arsyeshme stabilimenti i lindjes së kafshëve ose, nëse është e aplikueshme, stabilimenti i fundit i zinxhirit të furnizimit, dhe se që mjeti zëvendësues i identifikimit të tregojnë

numrin unik të regjistrimit të këtij stabilimenti ose, nëse është e aplikueshme në stabilimentin e fundit;

ç) në rastin e mbajtjes së kafshëve të llojit dele dhe dhi, zëvendësimi i mjeteve të identifikimit të përmendura në shkronjat “a” dhe “b”, me mjetet e reja identifikimi mund të autorizohet pajisja me një kod të ri identifikimi, me kusht që të mos cenohet gjurmueshmëria.

3. Zëvendësimi i mjeteve të identifikimit të përmendura në pikën 1 të këtij neni kryhet sa më shpejt që të jetë e mundur dhe përpara tejkallimit të një periudhe kohore maksimale, që përcaktohet nga Autoriteti Kompetent për Kontrolllet Zyrtare, i cili ka autorizuar operatorët për të zëvendësuar mjetet e identifikimit përpara se kafshët të lëvizin në një stabiliment tjetër.

4. Kur kodi i identifikimit të kafshëve të mbajtura të llojit gjedh, dele, dhi dhe derra, i shfaqur në mjetet e identifikimit të përmendura në shkronjat “a” dhe “b”, të shtojcës I, të urdhrit nr. 611, datë 8.8.2024, “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për regjistrimin e kafshëve në bazën e të dhënave kombëtare dhe gjurmueshmëria e tyre”, është i pamundur të riprodhohet si një identifikues elektronik për shkak të kufizimeve teknike, Autoriteti Kompetent për Kontrolllet Zyrtare lejon aplikimin e një kodi të ri identifikues për këto kafshë vetëm nëse të dyja kodet e identifikimit regjistrohen në bazat e të dhënave kompjuterike të referuara sipas pikës 1, të nenit 109, të ligjit nr. 41, datë 26.6.2025, “Për shëndetin e kafshëve”.

Neni 20

Autoritetet që ngarkohen

Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër botohet në Fletoren Zyrtare dhe fillon të zbatohet nga data 11.7.2027.

MINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla



SHTOJCA I
SPECIFIKIMET TEKNIKE PËR FORMATET E INFORMACIONIT NË BAZAT E TË
DHËNAVE KOMPJUTERIKE TË KAFSHËVE TË MBAJTURA TË LLOJIT GJEDH, DELE, DHI
DHE DERRA

Lloji i informacionit	Përshkrimi	Formati
Identifikimi i kodit të kafshës	Kodi i shtetit	Një nga mundësitë e mëposhtme: Kodi i shkronjës: kod ISO 3166-1 alfa-2 4 . Kodi numerik: Kodi numerik ISO 3166-1.
	Kod unik për secilën kafshë	12 karaktere numerike
Identifikues elektronikë (fakultative)		Një nga mundësitë e mëposhtme: - etiketë elektronike veshi; - bolus ruminal; - transponder i injektueshëm; - banda pastern elektronike.
Numri unik i regjistrimit të stabilimentit		Kodi i shtetit i ndjekur nga 12 karaktere alfanumerike.
Emri i operatorit të stabilimentit		140 karaktere alfanumerike.
Adresa e operatorit të stabilimentit	Rruga	140 karaktere alfanumerike.
	Kodi Postar	10 karaktere alfanumerike.
	Qyteti	35 karaktere alfanumerike.
Data		Data (VVVV-MM-DD).
Numri gjithsej i kafshëve		15 karaktere numerike.

SHTOJCA II
PJESA 1

Specifikimet teknike për mjetet e identifikimit të kafshëve të mbajtura të llojit gjedh, dele, dhi, derra, deve (*camelid*), drerë (*cervid*) dhe papagaj (*Psittacidae*)

1. Mjetet e identifikimit të përmendura në shkronjat “a”, “b”, “c”, “f” dhe “h”, të shtojcës 1, të urdhrorit nr. 611, datë 8.8.2024, “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për regjistrimin e kafshëve në bazën e të dhënave kombëtare dhe gjurmueshmëria e tyre”, të kafshëve të mbajtura të llojit gjedh, dele, dhi, derra, deve (*camelid*), drerë (*cervid*) dhe papagaj (*psittacidae*) janë:

- a) jo të ripërdorshëm;
- b) me material të padegradueshëm;
- c) të pa patjetërsueshëm;
- ç) të jetë lehtësisht i lexueshëm tek të gjitha kafshët përgjatë të gjithë jetëgjatësisë së tyre;
- d) të projektuara në mënyrë të tillë që ata mund të mbeten të bashkangjitura te kafshët në mënyrë të sigurt pa qenë të dëmshme për ato;
- dh) lehtësisht të heqshëm nga zinxhiri ushqimor.

2. Mjetet e identifikimit të përmendura në pikën 1 shfaqin në mënyrë të dukshme, të lexueshme dhe të pashlyeshme njërën nga sa vijon:

- a) elementet e para dhe të dyta të kodit të identifikimit të kafshës në përputhje me nenin 12;
- b) numrin unik të regjistrimit të stabilimentit të kafshëve të mbajtura dhe inkubatorit të miratuar nga Autoriteti Kompetent për Kontrollin Zyrtar; ose
- c) kodi alfanumerik i identifikimit referuar në pikën 1, të nenit 40, të urdhrorit nr. 611, datë 8.8.2024, “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për regjistrimin e kafshëve në bazën e të dhënave kombëtare dhe gjurmueshmëria e tyre”.



3. Mjetet e identifikimit të përmendura në pikën 1 mund të përmbajnë informacione të tjera, nëse autorizohen nga autoriteti kompetent për kontrollet zyrtare dhe me kusht që mjetet e identifikimit të jenë në përputhje me kërkesat e pikës 2.

PJESA 2

Specifikimet teknike për identifikuesit elektronik të kafshëve të mbajtura të llojit gjedh, dele, dhi, derra, deve (*camelid*) dhe drerë (*cervid*)

1. Identifikuesit elektronik të përmendur në shkronjat “c” deri në “f”, të shtojcës I, të urdhrit nr. 611, datë 8.8.2024, “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për regjistrimin e kafshëve në bazën e të dhënave kombëtare dhe gjurmueshmëria e tyre”, shfaqin elementin e parë të kodit të identifikimit të kafshëve në formën e kodit treshifror të shtetit dhe elementin e dytë të kodit të identifikimit të kafshëve në përputhje me nenin 12.

2. Identifikuesit elektronike të përmendur në pikën 1, janë:

a) vetëm për lexim, të transponderëve pasivë që aplikojnë teknologjinë HDX ose FDX-B, në përputhje me standardet ISO 11784 dhe 11785; dhe

b) të lexueshme nga pajisje në përputhje me ISO standarde 11785 dhe të aftë e duke lexuar transponderët HDX dhe FDX-B.

3. Identifikuesit elektronik të përmendur në pikën 1 lexohen në një distancë minimale leximi, si më poshtë:

a) për kafshë të mbajtura të llojit gjedh:

i. 12 centimetra, për matrikull për vesh kur lexoni me lexues portativ;

ii. 15 centimetra, për transponder të injektueshëm kur lexoni me lexues portativ;

iii. 25 centimetra, për boluse ruminale kur lexoni me lexues portativ;

iv. 80 centimetra, për të gjithë identifikuesit elektronik kur lexohen me një lexues të palëvizshëm;

b) për kafshë të mbajtura të llojit dele dhe dhi:

i. 12 centimetra, për matrikull veshi dhe brez elektronik mbi kurorën e thundrës kur lexoni me një lexues portativ;

ii. 20 centimetra, për boluse ruminale dhe transponderë të injektueshëm kur lexoni me lexues portativ;

iii. 50 centimetra, për të gjithë identifikuesit elektronik kur lexohen me lexues të palëvizshëm.

4. Identifikuesit elektronik të përmendur në pikën 1 testohen dhe të kenë rezultate të favorshme, në lidhje me:

a) përputhshmërinë me standardet ISO 11784 dhe 11785 në përputhje me metodën e përmendur në pikën 7 të standardit ISO 24631-1; dhe

b) performancën minimale në distancat e leximit të përmendura në pikën 3 të kësaj pjese, në përputhje me metodën e përmendur në pikën 7 të standardit ISO 24631-3.



URDHËR

Nr. 976, datë 7.10.2025

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE
ME PATOGJENITET TË LARTË TË
SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË
SHTETIN E GJERMANISË**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe të tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

- a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- b) zogjve 24-orësh;
- c) shpendëve dekorativë;
- d) materialit biologjik të shpendëve;
- e) vezëve të shpendëve;
- dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;
- e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuara termikisht.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Gjermanisë, janë sipas tabelës së mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3
Schleswig-Holstein	Steinburg	Schenefeld*
Mecklenburg-Vorpommern	Rostock	Tessin*
Nordrhein-Westfalen	Paderborn	Delbrück*
Thüringen	Greiz	Zeulenroda-Triebes*

Shënim: Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

3. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informojnë të gjitha subjektet importuese të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24- orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

Faqe | 22804

5. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht, që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 2.

7. Urdhri nr. 956, datë 2.10.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Gjermanisë”, shfuqizohet.

8. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla

URDHËR

Nr. 980, datë 8.10.2025

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE
ME PATOGJENITET TË LARTË TË
SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË
SHTETIN E POLONISË**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe të tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:



- a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- b) zogjve 24-orësh;
- c) shpendëve dekorativë;
- ç) materialit biologjik të shpendëve;
- d) vezëve të shpendëve;
- dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;
- e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuara termikisht.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Polonisë, janë sipas tabelës së mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3
Warmińsko-Mazurskie	Ilawa	Susz*
Warmińsko-Mazurskie	Kętrzyn	Reszel*
Wielkopolskie	Ostrzeszów	Mikstat*
Wielkopolskie	Turek	Przykona*

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

3. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informojnë të gjithë subjektet importuese të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24- orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

5. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 2.

7. Urdhri nr. 938, datë 29.9.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me

patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Polonisë”, shfuqizohet.

8. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla

URDHËR
Nr. 981, datë 8.10.2025

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE ME PATOGJENITET TË LARTË TË SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN E HOLANDËS

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe të tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

- a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- b) zogjve 24-orësh;
- c) shpendëve dekorativë;
- ç) materialit biologjik të shpendëve;
- d) vezëve të shpendëve;
- dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;
- e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuara termikisht.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Holandës, janë sipas tabelës së mëposhtme:



Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3
Drenthe	Aa en Hunze*	

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

3. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informojnë të gjithë subjektet importuese të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

5. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 2.

7. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla

URDHËR

Nr. 982, datë 8.10.2025

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË MURTAJËS AFRIKANE TË DERRAVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN E MOLDAVISË

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe të tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, mishin e freskët dhe produktet e tij, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, duke përfshirë mishin në një kontenier të vulosur (mbyllur) hermetikisht me një vlerë të F_0 prej 3 ose më lart, xhelatinën, ushqimin e thatë të kafshëve shtëpiake, dhe vakteve proteinike, sipas njoftimeve të marra nga faqja zyrtare e Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe ADIS-ës, përkatësisht nga ndarjet administrative të përcaktuara në tabelën e mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit 1*
Anenii Noi*
Briceni*
Cahul*
Calarasi*
Chişinău*
Cruleni*
Dubăsari*
Drochia*
Edineţ*
Făleşti*
Floreşti*
Găgăuzia*
Rîşcani*
Hînceşti*
Sîngerei*
Străşeni*
Şoldăneşti*
Soroca*
Ialoveni*
Ocnîţa*
Orhei*
Ungheni*
Glodeni*
Donduseni*
Leova*

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*



2. Lejimin e importit dhe e tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, mishin e freskët dhe produktet e tij, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, nga ndarjet administrative të shtetit të Moldavisë të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, të painfektuara nga sëmundja, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme nga pika 2.1 deri në pikën 2.8:

2.1. Për kafshët e gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që kafshët:**

a) nuk kanë shfaqur shenja klinike të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave ditën e dërgesës;

b) janë mbajtur që nga lindja ose për tre muajt e fundit në një kompartament (zonë) pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, ose;

c) janë mbajtur në një stacion karantine, të izoluar për 30 ditë përpara dërgesës dhe i janë nënshtruar një testi virologjik dhe një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas hyrjes në stacionin e karantinës, me rezultate negative.

2.2. Për materialin biologjik të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që kafshët donatore të materialit biologjik:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muajt para grumbullimit në një stacion, në të cilin janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tre vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstron dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së materialit biologjik;

c) sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur, në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

ç) sperma e përdorur për fekondimin e ovociteve është në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 15.1.10 ose nenin 15.1.11 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve, sipas rastit.

2.3. Për embrionet e derivuara *in vivo* të derrave të butë, **certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që kafshët donatore të embrioneve:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muajt para grumbullimit të embrioneve në një stacion, në të cilën janë mbikëqyrur, në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tre vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstron dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenjë klinike të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së embrioneve;

c) i janë nënshtruar një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas grumbullimit, me rezultate negative;

ç) embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me dispozitat përkatëse të kapitujve 4.8 dhe 4.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve.

2.4. Për mishin e freskët të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që:**

a) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshët e llojit derra që kanë origjinën nga tufat në të cilat janë mbikëqyrur, në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së murtajës afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tre vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstron dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) janë testuar mostra nga një numër statistikisht përfaqësues i kafshëve për sëmundjen e murtajës afrikane të derrave, me rezultate negative;

c) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshë të cilat janë therur në një thertore të miratuar dhe i janë nënshtruar kontrollit me rezultate të favorshme të inspektimit para dhe pas vdekjes, në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Shëndetësor të



Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

c) janë marrë masat e nevojshme pas therjes për të shmangur kontaktin e mishit të freskët me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.5. Për mishin e freskët të kafshëve të egra të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që:**

a) janë vrarë në një vend ose zonë të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave, në përputhje me pikën 1 ose pikën 2 të nenit 15.1.4 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

b) i janë nënshtruar me rezultate të favorshme një inspektimi pas ngordhjes, në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve në një objekt ekzaminimi të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti.

2.6. Për produktet e mishit të kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që:**

a) janë përgatitur nga mishi i freskët që plotëson kushtet përkatëse në nenet 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

b) mishi është përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti dhe ka plotësuar kushtet përkatëse të neneve 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve, ose;

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, në mënyrë që të sigurohet shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave, në përputhje me nenin 15.1.23 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit të mishit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.7. Për qimet (e pjesës së shpinës) e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që:**

a) e kanë origjinën nga derrat e egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose ndarje pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ose;

b) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave, në përputhje me një nga proceset e listuara në nenin 15.1.26 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin me produktin me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.8. Për lëkurët e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që:**

a) kanë ardhur nga derra të një vendi ose zonë të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave, në përputhje me pikën 1 ose pikën 2, të nenit 15.1.4, të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ose;

b) origjinojnë nga derra të egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose kompartament pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ose;

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave, në përputhje me një nga procedurat e përmendura në nenin 15.1.25 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat paraprake të nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve të informojnë të gjitha subjektet importuese të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

4. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe



Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre.

6. Urdhri nr. 781, datë 12.8.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, të shfaqur në shtetin Moldavisë”, shfuqizohet.

7. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla

URDHËR
Nr. 983, datë 8.10.2025

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË MURTAJËS AFRIKANE
TË DERRAVE, TË SHFAQUR NË
SHTETIN E LITUANISË**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, mishit të freskët dhe produkteve të tij, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, duke përfshirë mishin në një kontejner të vulosur (mbyllur) hermetikisht me një vlerë të F_0 prej 3 ose më lart, xhelatinën, ushqimin e thatë të kafshëve shtëpiake dhe vakteve proteinike, sipas njoftimeve të marra nga faqja zyrtare e Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe ADIS-it, përkatësisht nga ndarjet administrative të përcaktuara në tabelën e mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3
Panevezio	Panevëžio*	
Klaipėdos*		
Marijampolės*		
Šiauliai	Akmenės*	
Šiauliai	Šiaulių*	
Šiauliai	Kelmės*	
Šiauliai	Joniškio*	
Šiauliai	Pakruojo*	
Šiauliai	Radviliškio*	
Tauragės	Tauragės*	
Tauragės	Jurbarko*	
Tauragės	Šilalės*	
Telšiai	Telšių*	
Telšiai	Plungės*	

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Lejimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, mishit të freskët dhe produkteve të tij, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, nga ndarjet administrative të shtetit të Lituanisë, të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, të painfektuara nga sëmundja, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme nga pika 2.1 deri në pikën 2.8:

2.1 Për kafshët e gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët:**

a) nuk kanë shfaqur shenja klinike të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave ditën e dërgesës;

b) janë mbajtur që nga lindja ose për tre muajt e fundit në një kompartament (zonë) pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave; ose

c) janë mbajtur në një stacion karantine, të izoluar për 30 ditë përpara dërgesës dhe i janë nënshtruar një testi virologjik dhe një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas hyrjes në stacionin e karantinës, me rezultate negative.

2.2 Për materialin biologjik të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët donatore të materialit biologjik:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muajt para grumbullimit në një stacion, në të cilin janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së



murtajës afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tri vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstroi, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së materialit biologjik;

c) sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

ç) sperma e përdorur për fekundimin e ovociteve është në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 15.1.10 ose nenin 15.1.11 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve, sipas rastit.

2.3 Për embrionet e derivuara *in vivo* të derrave të butë, **certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që kafshët donatore të embrioneve:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit të embrioneve në një stacion, në të cilën janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërtetohet se asnjë rast i sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tri vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstroi, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së embrioneve;

c) i janë nënshtruar një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas grumbullimit, me rezultate negative;

ç) embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me dispozitat përkatëse të kapitujve 4.8 dhe 4.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve.

2.4 Për mishin e freskët të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që:**

a) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshët e llojit derra që kanë origjinën nga tufat në të cilat janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërtetohet se asnjë rast i sëmundjes së murtajës afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tri vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstroi, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) janë testuar mostra nga një numër statistikisht përfaqësues i kafshëve për sëmundjen e murtajës afrikane të derrave, me rezultate negative;

c) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshët të cilat janë therur në një thertore të miratuar dhe i janë nënshtruar kontrollit me rezultate të favorshme të inspektimit para dhe pas vdekjes në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

ç) janë marrë masat e nevojshme pas therjes për të shmangur kontaktin e mishit të freskët me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.5 Për mishin e freskët të kafshëve të egra të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që:**

a) janë vlarë në një vend ose zonë të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave në përputhje me pikën 1 ose pikën 2, të nenit 15.1.4 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

b) i janë nënshtruar me rezultate të favorshme një inspektimi pas ngordhjes në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve në një objekt ekzaminimi të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti.

2.6 Për produktet e mishit të kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që:**

a) janë përgatitur nga mishi i freskët plotëson kushtet përkatëse në nenet 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

b) mishi është përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti dhe ka plotësuar kushtet përkatëse të neneve 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, në mënyrë që të sigurohet shkatërrimi i virusit të murtajës



afrikane të derrave, në përputhje me nenin 15.1.23 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit të mishit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.7 Për qimet (e pjesës së shpinës) e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që:**

a) e kanë origjinën nga derrat e egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose ndarje pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

b) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me një nga proceset e listuara në nenin 15.1.26 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin me produktin me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.8 Për lëkurët e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që:**

a) kanë ardhur nga derra të një vendi ose zonë të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave, në përputhje me pikën 1 ose pikën 2, të nenit 15.1.4, të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

b) origjinojnë nga derra të egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose kompartament pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me një nga procedurat e përmendura në nenin 15.1.25 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat paraprake të nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve të informojnë të gjitha subjektet importuese të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

4. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre.

6. Urdhri nr. 795, datë 14.8.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, të shfaqur në shtetin e Lituanisë”, shfuqizohet.

7. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla

URDHËR
Nr. 163, datë 18.9.2025

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”; të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik” dhe të udhëzimit nr. 4, datë 29.1.2020, “Për delegimin e të drejtave dhe detyrave në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”,



URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit, për nisjen dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit për blerjet me vlera të vogla apo direkte, si dhe nënshkrimin e kontratave për ushtrimin e aktiviteteve të AZHT-së të drejtori i Drejtorisë së Monitorimit në Territor, z. Saimir Lita.

2. Kompetenca e deleguar sipas pikës 1 të këtij urdhri, do të ushtrohet nga data e hyrjes në fuqi e këtij urdhri deri më datë 31.12.2025.

3. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri drejtori i Drejtorisë së Monitorimit në Territor, z. Saimir Lita.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Adelajda Roka

VENDIM
Nr. 47, datë 18.9.2025

**NË EMËR TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,
e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Ilir Toska	anëtar;
Genti Ibrahim	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Marsida Xhaferllari	anëtare,

me sekretare Anjeza Puka, në datën 18.9.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 3 (I) 2025 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Tom Dedaj, përfaqësuar nga avokat Bexhet Lata, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, përfaqësuar nga Danja Hobdari dhe Albion Salaj, me autorizim.

Prokuroria e Përgjithshme, në mungesë.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, në mungesë.

Këshilli i Ministrave, përfaqësuar nga Herald Jonuzaj, me autorizim.

Avokatura e Shtetit, përfaqësuar nga avokatet e shtetit Valbona Legisi dhe Irma Qosja.

OBJEKTI: Ndrejje gabimi në vendimin nr. 4, datë 21.1.2025, të Gjykatës Kushtetuese, për sa i takon miratimit të shpenzimeve gjyqësore.

BAZA LIGJORE: Neni 310 i Kodit të Procedurës Civile (KPC); nenet 28 dhe 80 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Marsida Xhaferllari, mori në shqyrtim prapësimet me shkrim të kërkesit Tom Dedaj (*kërkuesi*), që ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Këshillit të Lartë të Prokurorisë (KLP), që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Këshillit të Ministrave, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Avokaturës së Shtetit, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, konstatoi mungesën e prapësimeve me shkrim të subjekteve të tjera të interesuara, Prokurorisë së Përgjithshme dhe Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër (*Prokuroria e Dibrës*), si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I
Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi në datën 9.7.2024 i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual me objekt konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm të gjykimit të çështjes së tij nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë dhe shfuqizimin e vendimit të gjykatës së apelit që e kishte rrëzuar atë. Pas kontrollit paraprak, çështja ka kaluar për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

2. Në vijim, kërkuesi përmes avokatit të tij ka paraqitur parashtrimet shtesë, ku, ndër të tjera, ka kërkuar edhe caktimin e shpenzimeve gjyqësore në ngarkim të KLP-së, Prokurorisë së Përgjithshme



dhe Prokurorisë së Dibrës, në vlerën gjithsej 201 200 lekë.

3. Në përfundim, Gjykata, me vendimin nr. 4, datë 21.1.2025 (*vendimi nr. 4/2025*), ka vendosur pranimin e kërkesës, shfuqizimin e vendimit objekt kundërshtimi, konstatimin e cenimit të së drejtës për një gjykim brenda afatit të arsyeshëm dhe detyrimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë të shqyrtojë çështjen e kërkuarit me përparësi. Ndërkohë, Gjykata nuk është shprehur për kërkimin që lidhet me shpenzimet gjyqësore. Vendimi është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 40, datë 26.2.2025.

4. Në datën 3.4.2025 kërkuarisi i është drejtuar sërish Gjykatës me kërkesë sipas objektit. Kolegji i Gjykatës, në datën 5.6.2025 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve, ndërsa kjo e fundit, në datën 24.6.2025, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

5. **Kërkuarisi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se bazuar në nenet 28 dhe 80 të ligjit nr. 8577/2000, Gjykata duhet të shprehet për shpenzimet gjyqësore në vlerën gjithsej 201 200 lekë në ngarkim të palës së paditur solidarisht, KLP-së, Prokurorisë së Përgjithshme dhe Prokurorisë së Dibrës, të cilat janë dokumentuar prej tij me fatura shpenzimesh.

6. **Subjekti i interesuar, KLP-ja**, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar se shpenzimet nuk mund t'i ngarkohen atij, në kushtet kur nuk është bërë shkak i shkeljes kushtetuese. Për më tepër, edhe në gjykimin që po zhvillohet pranë gjykatave të zakonshme, gjykata e shkallës së parë i ka rrëzuar pretendimet e kërkuarit ndaj KLP-së për mungesë të legjitimitetit pasiv, duke ia ngarkuar shpenzimet gjyqësore Prokurorisë së Përgjithshme dhe Prokurorisë së Dibrës.

7. **Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave**, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar se neni 80 i ligjit nr. 8577/2000 nuk është i aplikueshëm, pasi trajton vetëm rastet e gabimeve materiale në tekstin e vendimit. Neni 28, pika 2, i ligjit nr. 8577/2000 trajton vetëm shpenzimet e përfaqësimit, ndaj shpenzimet e tjera për kancelarinë dhe ditët e punës nuk mund të njihen. Shpenzimet e përfaqësimit duhet t'i ngarkohen subjektit të interesuar në gjykim,

i cili është palë në procesin gjyqësor të zakonshëm. Këshilli i Ministrave dhe Ministria e Financave nuk zotërojnë buxhet për llogari të subjekteve të tjera.

8. **Subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit**, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar se masa e shpenzimeve të përfaqësimit nuk duhet caktuar në mënyrë arbitrare, por duhet të përfshijë ato që janë reale, të nevojshme dhe të dokumentuara, duke mbajtur në konsideratë edhe kompleksitetin e çështjes. Shpenzimet duhet t'i ngarkohen subjektit të interesuar në gjykim, por duke mbajtur në konsideratë edhe gjendjen ekonomike të tij. Në rastet kur subjekt i interesuar është institucion publik, shpenzimet e përfaqësimit nuk mund t'i ngarkohen Ministrisë së Financave ose gjykatës në mënyrë abstrakte dhe as Këshillit të Ministrave, i cili nuk zotëron buxhet për llogari të subjekteve të tjera. Në rastin konkret, shpenzimet e përfaqësimit duhet t'u ngarkohen subjekteve të interesuara që kanë qenë palë në gjykim, KLP-së, Prokurorisë së Përgjithshme dhe Prokurorisë së Dibrës. Po kështu, Gjykata ka diskrecionin që në vendimin përfundimtar të caktojë edhe mënyrën e ekzekutimit.

9. **Subjektet e interesuara, Prokuroria e Përgjithshme dhe Prokuroria e Dibrës**, nuk kanë paraqitur prapësime me shkrim edhe pse janë njoftuar rregullisht nga Gjykata.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

10. Në rastet kur Gjykata vihet në lëvizje për plotësimin e vendimit të saj, legjitimiteti i kërkuarit dhe procedura parashikohen në nenin 80 të ligjit nr. 8577/2000. Sipas kësaj dispozite, Gjykata ka të drejtë, me kërkesë, të ndreqë gabimet në shkrim, në llogari ose ndonjë pasaktësi të dukshme të lejuar në vendim, pa ndryshuar thelbin e vendimmarrjes, brenda 2 muajve nga shpallja e vendimit. Vendimi i Gjykatës në këto raste publikohet në Fletoren Zyrtare. I njëjti rregull parashikohet edhe në nenin 43 të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese (*Rregullorja*), sipas të cilit kur kërkesa ka të bëjë me një vendim përfundimtar, kompetente për shqyrtimin e saj është Gjykata.

11. Në kuptim të këtyre dispozitave, Gjykata çmon se kërkuarisi legjitimohet në paraqitjen e kërkesës sipas objektit, pasi ka qenë palë pjesëmarrëse në gjykimin për të cilin është dhënë vendimi nr. 4/2025 i Gjykatës dhe i është drejtuar



asaj brenda 2 muajve nga shpallja e vendimit. Po kështu, kërkimi për të plotësuar vendimin edhe me disponimin për shpenzimet gjyqësore, sipas nenit 28 të ligjit nr. 8577/2000, hyn në kompetencën lëndore të Gjykatës të përcaktuar nga neni 80 i të njëjtit ligj, i cili emërtohet “*Saktësimi dhe plotësimi i vendimit*”, pasi është kërkim i paraqitur në parashtrimet shitesë të ankimit individual të parë dhe nuk ndryshon thelbin e vendimmarrjes, ndaj në vijim Gjykata do ta analizojë atë në themel.

12. Gjykata vëren se në nenin 28 të ligjit nr. 8577/2000, i cili është përfshirë për herë të parë në vitin 2016, me ndryshimet e miratuara që reformuan, ndër të tjera, ankimin kushtetues individual, janë parashikuar rregulla për sa u takon shpenzimeve gjyqësore, sipas të cilave, shpenzimet e procesit gjyqësor para saj u nënshtrohen rregullave të parashikuara në ligjin për tarifat gjyqësore (*pika 1*); kur ajo vendos pranimin e ankimit individual kushtetues, ajo mund të shprehet edhe për shpenzimet e përfaqësimit pjesërisht ose tërësisht, nëse kërkohet nga kërkuesi (*pika 2*). Kjo dispozitë është konkretizuar edhe në nenin 14 të Rregullores, sipas së cilës kur Gjykata vendos pranimin e ankimit kushtetues individual, ajo shprehet në dispozitiv edhe për shpenzimet e përfaqësimit dhe masën e tyre, nëse kjo kërkohet nga kërkuesi (*pika 4*).

13. Në kontekst të këtyre parashikimeve, të cilat nuk janë zbatuar deri më tani në praktikën e saj, Gjykata çmon të analizojë paraprakisht disa çështje juridike, që kanë të bëjnë me: i. afatin e paraqitjes së kërkesës për shpenzimet gjyqësore në procesin kushtetues, pra nëse një kërkesë e tillë mund të paraqitet së bashku me ankimin kushtetues individual, gjatë gjykimit deri në shpalljen e vendimit apo në çdo kohë, por gjithsesi jo më vonë se 2 muaj nga shpallja e vendimit; ii. kriteret dhe dokumentet mbi bazën e të cilave caktohet masa e shpenzimeve të përfaqësimit; iii. subjektin që i ngarkohen shpenzimet e përfaqësimit, në rast pranimi të kërkesës: a) subjekti i interesuar që është palë e procesit gjyqësor të zhvilluar në gjykatat e zakonshme; b) subjekti i interesuar që ka nxjerrë vendimin gjyqësor ose aktin e pushtetit publik, që shfuqizohet nga gjykata; c) Ministria e Financave, në kushtet kur ligji ngarkon Këshillin e Ministrave që me anën e organeve përkatëse të administratës shtetërore të sigurojë ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës; iv. mënyrën, afatet dhe procedurën e ekzekutimit të shpenzimeve të përfaqësimit.

14. Lidhur me këto çështje kërkuesi ka parashtruar se shpenzimet e përfaqësimit janë pjesë integrale e çdo procesi gjyqësor dhe ato kërkohen në bazë të faturave përkatëse tatimore, përfshirë edhe ato që lidhen me ditët e humbura për pjesëmarrjen në gjykim të palëve, dëshmitarët, ekspertët, udhëtimin, ushqimin, akomodimin dhe gjithçka të shpenzuar. Sipas tij, faturat e shpenzimeve duhet të paraqiten gjatë shqyrtimit gjyqësor, për shkak të dinamikës së procedurave dhe Gjykata duhet të shprehet për mënyrën dhe afatin e ekzekutimit sipas shembullit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Ndërsa, subjektet e interesuara, Këshilli i Ministrave dhe Avokatura e Shtetit, kanë prapësuar se në kuptim të nenit 28 të ligjit nr. 8577/2000, kërkesa për shpenzimet gjyqësore duhet të paraqitet së bashku me ankimin kushtetues individual, me qëllim që t’u jepet mundësia subjekteve të interesuara për t’u shprehur lidhur me to. Gjykata duhet të shprehet vetëm për shpenzimet e përfaqësimit të dokumentuara sipas përcaktimeve ligjore në fuqi dhe krahas kontratës së shërbimit me avokatin duket të jetë edhe fatura tatimore përkatëse, ndërsa asnjë nga shpenzimet e tjera, si ato që lidhen me kancelarinë dhe ditët e punës, nuk mund të jenë objekt vendimmarrjeje nga Gjykata dhe asnjë dokument i lidhur me këto kosto nuk ka vlerë për gjykimin kushtetues. Shpenzimet gjyqësore duhet t’i ngarkohen palës ndërgjyqëse në disfavor të së cilës është shprehur gjykata e faktit, duke mbajtur në konsideratë edhe gjendjen ekonomike ose, sipas rastit, atij organi apo institucionit që është përgjegjës për zbatimin e vendimit të Gjykatës. Ato nuk mund t’i ngarkohen gjykatës ose Ministrisë së Financave në mënyrë abstrakte. Po sipas tyre, Këshilli i Ministrave dhe Ministria e Financave nuk zotërojnë buxhet për llogari të subjekteve të tjera. Për sa i përket mënyrës së ekzekutimit, përcaktimi mbetet në atribut të vetë Gjykatës. Ndërsa, sipas subjektit tjetër të interesuar, KLP-së, shpenzimet nuk mund t’i ngarkohen atij në kushtet kur nuk është bërë shkak i shkeljes kushtetuese.

15. Gjykata thekson se në parim çështja e shpenzimeve të përfaqësimit në gjykimin kushtetues të ankimit individual është pjesë e procesit të rregullt ligjor dhe refuzimi për mbulimin e tyre rrezikon të kufizojë në mënyrë të pajustificuar të drejtën e individit për akses në gjykatë, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës.



16. Nën këtë optikë, Gjykata vëren se ligji nr. 8577/2000 nuk ka parashikuar në mënyrë të shprehur afatin konkret brenda të cilit kërkuesi mund të paraqesë kërkesë për shpenzimet e përfaqësimit, por është mjaftuar me shprehjen “*nëse kërkohet nga kërkuesi*”. Në vlerësimin e Gjykatës kjo do të thotë se, *së pari*, disponimi për shpenzimet vihet në lëvizje vetëm me kërkesë formale nga ankuesi dhe, *së dyti*, një kërkesë e tillë mund të paraqitet së bashku me ankimin kushtetues individual deri kur deklarohet mbyllja e seancës plenare nga Gjykata.

17. Po kështu, Gjykata vë në dukje se individ i ka të drejtën e mbulimit të shpenzimeve vetëm nëse vërteton se ato janë kryer, kanë qenë të nevojshme dhe në masë të arsyeshme. Për këtë arsye, kërkesa duhet të shoqërohet me akte që dokumentojnë në mënyrë reale dhe të nevojshme masën e shpenzimeve të kryera për qëllim të procesit kushtetues, të cilat në çdo rast duhet të jenë të arsyeshme dhe të shoqëruara me fatura tatimore të lëshuara sipas legjislacionit në fuqi. Sipas udhëzimit të përbashkët nr. 18, datë 5.8.2020 të ministrit të Drejtësisë dhe ministrit të Financave “Për miratimin e kriterëve të përfitimit të pagesave dhe tarifave të shpërblyerit të avokatëve që ofrojnë ndihmë juridike dytësore”, shpenzimet për ofrimin e mbrojtjes juridike për përfaqësimin në Gjykatë përcaktohen në vlerat 50 000 lekë dhe 60 000 lekë, ndërsa për shërbime jashtëgjyqësore përcaktohen në vlerat 25 000 lekë (përgatitje kërkesë) dhe 500 deri në 1500 lekë ora (ofrimi i ndihmës juridike në formën e këshillimit - shih rubrikat I dhe II të shtojcës 1, “*Tarifat e shërbimeve juridike të avokatëve të ndihmës juridike*”). Nga ana tjetër, kriteret bazë për llogaritjen e masës lidhen me: kompleksitetin e çështjes, nivelin e formimit dhe përvojën juridike të kërkuesit për të kuptuar çështjen, moshën dhe gjendjen financiare të kërkuesit, si dhe elemente të tjera që ndikojnë në vlerën e kërkuar.

18. Për sa i takon subjektit që ngarkohet për mbulimin e shpenzimeve të përfaqësimit, Gjykata vë në dukje se natyra dhe objekti i gjykimit kushtetues ndryshojnë nga gjykimi i zakonshëm, ku në këtë të fundit shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palëve ndërgjyqëse sipas disponimit të gjykatës së zakonshme. Përkundër kësaj, në gjykimin kushtetues individ i kërkon të mbrojtje të drejtat themelore të shkelura si pasojë e veprimtarisë së autoriteteve publike, ku përfshihet edhe ajo e

gjykatave të zakonshme, që i kanë pasjellë atij cenimin e të drejtave themelore, ndaj përgjegjësia në këtë gjykim i takon vetë shtetit. Në këtë këndvështrim, një logjikë analoge ndiqet nga rregullimet ligjore për kompensimin për arrestin në shtëpi, paraburgim dhe burgim të padrejtë, ku shpenzimet përballohen nga buxheti i shtetit (*neni 9 i ligjit nr. 9381, datë 28.4.2005, “Për kompensimin e burgimit të padrejtë”*) ose ato për kompensimin e shkeljes të së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, ku në gjykimin e zakonshëm thirren të paditur Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave (*neni 399/4, pika 2, i KPC-së*).

19. Mbi bazën e këtyre standardeve, në rastin konkret Gjykata vëren se kërkimi i kërkuesit për shpenzimet gjyqësore është paraqitur brenda afatit, pasi ai është depozituar përpara marrjes së vendimit për pranimin e ankimit kushtetues individual. Kërkuesi e ka paraqitur personalisht vetë ankimin kushtetues individual dhe në atë fazë nuk ka qenë i përfaqësuar me avokat. Pas njoftimit nga Gjykata se çështja e tij ka kaluar për shqyrtim në seancë plenare, kërkuesi në datën 8.10.2024 ka lidhur një marrëveshje për shpërblyerimin e avokatit (në format të thjeshtë dhe të panoterizuar) përmes së cilës ka emëruar si përfaqësues ligjor të tij një avokat. Sipas marrëveshjes, kërkuesi bie dakord që avokati ta përfaqësojë në të gjitha fazat dhe shkallët e gjykimit deri në ekzekutimin e plotë të vendimeve kundrejt shpërblyerimit në vlerën 140 000 lekë. Pas rreth 16 ditëve, në datën 24.10.2024 është lëshuar fatura tatimore në vlerën 140 000 lekë, me përshkrimin “*Përfaqësim për çështje administrative pranë Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë*”. Një ditë më pas, në datën 25.10.2024, përpara noterit është nënshkruar prokura e përgjithshme për emërimin e avokatit në cilësinë e përfaqësuesit ligjor të kërkuesit, të cilit i jepej tagri i përfaqësimit në çdo gjykatë dhe për çdo çështje civile ose familjare, administrative dhe penale, si dhe në procedurat jashtëgjyqësore në të cilat ai është palë. Në të njëjtën datë është lëshuar edhe fatura tatimore në vlerën 6 200 lekë, me përshkrimin “*Faturë shitjeje e gjeneruar për listë shërbimesh*”. Sipas përshkrimeve në aktet e paraqitura, “Marrëveshja për shpërblyerimin e avokatit” dhe “Prokura e përgjithshme”, konstatohet se përfaqësimi i kërkuesit nga avokati nuk i referohet vetëm shqyrtimit të çështjes përpara Gjykatës, por të gjitha çështjeve pavarësisht natyrës dhe shkallës së gjykimit në të cilat ai është palë. Ndërsa shpenzimet



për ditët e punës dhe kancelarinë në vlerën 55 000 lekë pasqyrohen në nivel deklarativ e të pashoqëruara me akte provuese.

20. Për sa më lart, duke marrë në konsideratë se ankimi kushtetues është paraqitur nga vetë kërkuesi, i cili ka formimin e përvojën e mjaftueshme për të kuptuar çështjen dhe se gjykimi kushtetues i përfunduar me vendimin nr. 4/2025 nuk ka qenë kompleks, Gjykata i vlerëson shpenzimet e përfaqësimit në vlerën 50 000 lekë. Detyrimi për pagimin e kësaj vlere i ngarkohet Ministrisë së Financave. Në këtë pikë, Gjykata vë në dukje se afati për përmbushjen e detyrimit për mbulimin e shpenzimeve të përfaqësimit duhet të jetë i arsyeshëm deri në masën që mos të humbasë qëllimin e tij legjitim.

21. Në përfundim, Gjykata çmon se kërkesa për shpenzimet e përfaqësimit është e drejtë dhe duhet pranuar pjesërisht.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, bazuar në nenin 80 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Pranimin e pjesshëm të kërkesës.
2. Plotësimin e vendimit nr. 4, datë 21.1.2025 të Gjykatës Kushtetuese në dispozitivin e tij, si më poshtë:

“Shpenzimet e përfaqësimit të kërkuarit në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë i ngarkohen Ministrisë së Financave”.

3. Një kopje e këtij vendimi i bashkohet vendimit përfundimtar nr. 4, datë 21.1.2025 të Gjykatës Kushtetuese.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 18.9.2025.

Shpallur më 10.10.2025.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë: Sonila Bejtja, Fiona Papajorgji, Genti Ibrahim, Sandër Beci, Ilir Toska, Marsida Xhaferllari, Marjana Semini

VENDIM

Nr. 1395, datë 9.10.2025

PËR DHËNIEN E MANDATIT TË DEPUTETIT TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË, Z. BESNIK XHEMAL BRAHIMI, KANDIDAT I LISTËS SHUMEMËRORE TË PARTISË SOCIALDEMOKRATE, QARKU SHKODËR, PËR ZGJEDHJET PËR KUVEND TË DATËS 11 MAJ 2025

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronjat “i”, “n”, e 2, 163, pika 3, 164, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; të nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, dhe të kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, ‘Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike’”, pasi shqyrtova dokumentacionin përkatës,

VËREJ:

Me shkresën nr. 2408/1 prot., datë 15.9.2025, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, vakancë kjo e krijuar për shkak të dorëheqjes së deputetit, z. Tom Gjek Doshi, i zgjedhur në zonën zgjedhore qarku Shkodër, i propozuar nga “Partia Socialdemokrate”.

Partia Socialdemokrate, është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, me vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 177, datë 25.2.2025.

Komisioni Rregullator, me vendimin nr. 34, datë 28.8.2025, shpalli rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, të zhvilluara në datë 11.5.2025.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, nëpërmjet vendimit nr. 1340, datë 27.6.2025, miratoi shpërndarjen e mandateve midis subjekteve zgjedhore dhe përcaktimin e kandidatëve fitues në



zonën zgjedhore qarku Shkodër, për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 Maj 2025.

Sipas këtij vendimi, Partia Socialdemokrate, për zonën zgjedhore qarku Shkodër, për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë të datës 11 Maj 2025, ka fituar 2 (dy) mandate.

Rezultoni se lista shumemërore e Partisë Socialdemokrate, në zonën zgjedhore qarku Shkodër, i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67 të Kodit Zgjedhor, duke përfshirë dhe kriterin e gjinisë.

Zëvendësimi i vakancës do të bëhet në mbështetje të nenit 164 pika 2, të Kodit Zgjedhor, si dhe vendimit nr. 1340, datë 27.6.2025, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve në të cilin është miratuar shpërndarja e mandateve midis subjekteve zgjedhore si dhe përcaktimi i kandidatëve fitues në zonën zgjedhore qarku Shkodër, për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 Maj 2025.

Sipas këtij vendimi, rezultoni se kandidati të cilit i kalon mandati i deputetit, është kandidati me numër rendor 01 (një), në listën me parapëlqim, z. Besnik Xhemal Brahimi.

Me shkresën nr. 6245 prot., datë 30.9.2025, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i është drejtuar kandidati për deputet të Partisë Socialdemokrate, në zonën zgjedhore qarku Shkodër, z. Besnik Xhemal Brahimi, me kërkesë për plotësim dokumentacioni.

Referuar nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për Kuvendin të cilit i takon të marrë mandatin e deputetit për vendin vakant.

Kandidati për deputet, z. Besnik Xhemal Brahimi, ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër 24087 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i deputetit.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 dhe kreut V, pika 2, shkronja “b” dhe pika 3, shkronja “c”, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike, ka kërkuar informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, si dhe nga Drejtoria

e Përgjithshme e Burgjeve, për z. Besnik Xhemal Brahimi, si dhe ka bërë publikimin e formularit të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile nuk i ka kthyer ende përgjigje kërkesës sonë, për verifikimin e të dhënave për kandidatin për deputet, në zonën zgjedhore qarku Shkodër, për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, z. Besnik Xhemal Brahimi.

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin për deputet, në zonën zgjedhore qarku Shkodër, për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, z. Besnik Xhemal Brahimi, ku konstatohet se kandidati në fjalë rezultoi i rehabilituar në bazë të nenit 69 të Kodit Penal.

Pas verifikimeve të kryera, referuar pikës 2, të keut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, konstatohet se të dhënat e kandidati për deputet, në zonën zgjedhore qarku Shkodër, për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, z. Besnik Xhemal Brahimi, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidati në funksionin e deputetit në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë.

Për sa më sipër, mandati i ndërprerë i deputetit z. Tom Gjek Doshi, i përket kandidati vijues në listën shumemërore të Partisë Socialdemokrate, në zonën zgjedhore qarku Shkodër, i renditur me numër rendor 01 (një), në listën me parapëlqim, z. Besnik Xhemal Brahimi.

PËR KËTO ARSYE,

bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronjat “i”, “n”, e 2, 163, pika 3, 164, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; në nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, dhe në kreun V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, ‘Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike’”,

VENDOS:

1. Dhënie e mandatit të deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidati të radhës në



listën shumemërore të Partisë Socialdemokrate, në zonën zgjedhore qarku Shkodër, z. Besnik Xhemal Brahimi.

2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e tij.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONERI SHTETËROR
I ZGJEDHJEVE
Ilirjan Celibashi

KËRKESË
Nr. 407/14, datë 10.10.2025

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën për projektin “Studim-projektim, aksi rrugor Elbasan–Lekaj, korridori 8, loti I (faza I, II, III) Elbasan–Papër”. Subjekti kërkuar i këtij projekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasurinë pronë private, sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, për pasuritë e llojit “truall” dhe “arë”,

bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë” dhe për pasuritë e llojit “ndërtesë”, sipas VKM-së nr. 138, datë 23.3.2000, Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që zhvlerësohen dhe të drejtave të personave të tretë për interes publik, sipas tabelës paraprake bashkëlidhur.

Vlera totale paraprake e shpronësimit 46,482,821.4 (dyzet e gjashtë milionë e katërqind e tetëdhjetë e dy mijë e tetëqind e njëzet e një pikë katër) lekë.

Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar, dhe personat të cilët preken, por nuk figurojnë në listë, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit të Autoriteti Rrugor Shqiptar, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësim.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Ermal Shena



LISTA PARAPRAKE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN, PËR INTERES PUBLIK, NGA PROJEKTI “STUDIM-PROJEKTIM, AKSI RRUGOR ELBASAN–LEKAJ, KORRIDORI 8, LOTI I (FAZA I, II, III), ELBASAN–PAPËR”

				TË DHËNA (mbi pasurinë sipas ASHK-së)				VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM SIPAS LLOJIT											
Nr.	Emër	Atësi	Mbiemër	Zona kadastrale	Nr. pasurie	Lloji i pasurisë	Sipërfaqe totale	Shpronësimi tokë arë			Shpronësimi tokë “truall”			Shpronësimi ndërtesë banimi			Totali	Shënime	
								Sip. (m²)	Çmimi (leke/m²)	Vlera (m²)	Sip. (m²)	Çmimi (leke/m²)	Vlera (m²)	Sip. (m²)	Çmimi (leke/m²)	Vlera (m²)			
1	SHTET			2124	109/1	ARË	3633	788	0	0.0							0.0	Mbi këtë pasuri ndodhet objekti i legalizuar me nr. 109/1/1-ND v. 11, f. 205, në pronësi të Nexhip Meta; mbi këtë pasuri ndodhet objekti i legalizuar me nr. 107/11/1-ND, v. 11 f. 222 në pronësi të Alban Rramci	
2	SHTET			2124	109/5	ARË	4000	1047	0	0.0							0.0		
3	SHTET			2124	144/8	KANAL	3559	193	0	0.0							0.0		
4	SHTET			2124	143/6	LEDH	925	178	0	0.0							0.0		
5	SHTET			2124	143/1	KANAL	33438	456	0	0.0							0.0		
6	SHTET			2124	143/2	RRUGË	4486	573	0	0.0							0.0		
7	SHTET			3965	755	RRUGË	116	116	0	0.0							0.0		
8	SHTET			3965	765	TRUALL	16184				12931	0	0.0				0.0		
9	SHTET			3965	783	TRUALL	7537				3415	0	0.0				0.0		
10	SHTET			3965	784	TRUALL	8				8	0	0.0				0.0		
11	SHTET			3965	785	TRUALL	218				218	0	0.0				0.0		
12	SHTET			3965	786	RRUGË	3456	741	0	0.0							0.0		
13	SHTET			3965	791	TRUALL	7006				3315	0	0.0				0.0		
14	SHTET			3965	788/3	TRUALL	1157				1159	0	0.0				0.0		
15	SHTET			3965	797/2	TRUALL	2472				108	0	0.0				0.0		
16	SHTET			3965	796/1	TRUALL	1436				1381	0	0.0				0.0		
17	SHTET			3965	796/2	TRUALL	4668				4668	0	0.0				0.0		
18	SHTET			3965	743	TRUALL	311				304	0	0.0				0.0		
19	SHTET			3965	720	TRUALL	4869				3868	0	0.0				0.0		
20	SHTET			3965	688	RRUGË	4679	1745	0	0.0							0.0		
21	SHTET			1258	312	LUMË	442510	8583	0	0.0							0.0		
22	SHTET			1258	20/1/4	RRUGË	14620	1831	0	0.0							0.0		
23	SHTET			1258	20/1/11	KULLOTË	18014	8895	0	0.0							0.0	Mbi këtë pasuri ndodhet objekti i legalizuar me nr. 20/1/11-ND, v. 9, f. 177 në pronësi të Dashamir Moli	
24	SHTET			1258	20/1/12	KANAL	3475	830	0	0.0							0.0		
25	SHTET			1258	20/1/24	ARË	2438	1510	0	0.0							0.0		
26	SHTET			1258	20/1/28	KULLOTË	670	580	0	0.0							0.0		
27	SHTET			1258	20/1/29	KULLOTË	2663	996	0	0.0							0.0		
28	SHTET			1258	20/1/41	ARË	8215	4488	0	0.0							0.0		
29	MUSTAFA QAZIM DUJA			1258	20/1/13	ARË	5000	677	222	150,294.0							150,294.0		
30	SHTET			3764	330/29	PYLL	67925	5843	0	0.0							0.0		
31	SHTET			3764	329/43	ARË	4982	2990	0	0.0							0.0		
32	SHTET			3764	240/3	RRUGË	1465	371	0	0.0							0.0		
33	SHTET			3764	329/35	ARË	1352	72	0	0.0							0.0		
34	SHTET			3764	329/39	ARË	700	181	0	0.0							0.0		
35	SHTET			3764	329/40	ARË	1129	275	0	0.0							0.0		
36	SHTET			3764	240/14	ARË	5238	3637	0	0.0							0.0		
37	DEMIR ISUF ÇELA			3764	329/37	ARË	1044	43	222	9,546.0							9,546.0		
38	SHTET			3764	329/41	ARË	1448	421	0	0.0							0.0		



39	SHTET	3764	329/42	ARË	845	289	0	0.0						0.0	Ne seksionin E të kartelës ka shënimin: kjo pasuri posedohet nga RAMAZAN YMER ÇELA
40	REPUBLIKA E SHQIPËRISË	3764	330/1/3	ARË	4113	115	0	0.0						0.0	
41	SHTET	3764	240/1	ARË	5783	1130	0	0.0						0.0	Ne seksionin E të kartelës ka shënimin: kjo pasuri posedohet nga ZYBER ISMAIL ÇELA
42	SHTET	3764	240/13	ARË	4724	1132	0	0.0						0.0	
43	SHTET	3764	240/15	ARË	3695	397	0	0.0						0.0	
44	SHTET	3764	240/16	ARË	4285	2561	0	0.0						0.0	Ne seksionin E të kartelës ka shënimin: kjo pasuri posedohet nga NEBI RRAPUSH ÇELA
45	SHTET	3764	329/33	ARË	2261	276	0	0.0						0.0	Ne seksionin E të kartelës ka shënimin: kjo pasuri posedohet nga BASHKIM RRAPUSH XHAKAJ
46	SHTET	3764	329/34	ARË	809	92	0	0.0						0.0	Ne seksionin E të kartelës ka shënimin: kjo pasuri posedohet nga REFIK RRAPUSH XHAKAJ
47	SHTET	3764	240/2	ARË	10627	2522	0	0.0						0.0	Ne seksionin E të kartelës ka shënimin: kjo pasuri posedohet nga SKENDER ISUF XHAKAJ
48	ZYHDI QAZIM IBRO	2876	139/5/1	ARË	3233	1311	222	291,042.0						291,042.0	Te përshkrimi i veçantë ka shënimin: kjo pasuri i përket ngastrës me emrin popullor "RREKAS", me sipërfaqe 3233 m ² sipas AMTP nr. 21
49	PETREF REXHEP SENA	2876	139/12/1	ARË	7000	1959	222	434,898.0						434,898.0	
50	PETREF REXHEP SENA	2876	139/55/1	ARË	3100	677	222	150,294.0						150,294.0	
51	SHTET	2876	139/55/2	ARË	4184	1065	0	0.0						0.0	
52	KUJTIM HAMIT SUBASHI	2876	139/21/1	ARË	3721	797	222	176,934.0						176,934.0	
53	ISAT HAZBI SUBASHI	2876	139/23/1	ARË	833	190	222	42,180.0						42,180.0	
54	SHYQYRI QAZIM SUBASHI	2876	139/27/1	ARË	3438	793	222	176,046.0						176,046.0	
55	ANILA AVNI XHAKOJ ELVIRA AVNI XHAKOJ	2876	139/29/1	ARË	2599	394	222	87,468.0						87,468.0	
56	QANI SELMAN KARAJ	2876	139/31/1	ARË	1856	313	222	69,486.0						69,486.0	Te përshkrimi i veçantë ka shënimin: me dok. me ref. 0188, datë 13.8.2013, është bërë rivlerësimi i pasurisë në vlerën 701568 lekë.
57	SHTET	2876	139/31/2	ARË	1134	83	0	0.0						0.0	
58	SHAQIR JONUZY DYBELI	2876	139/9	ARË	3061	1132	222	251,304.0						251,304.0	
59	SHAQIR JONUZY DYBELI	2876	139/10	ARË	4256	1168	222	259,296.0						259,296.0	
60	BAJRAM REXHEP BENA RAMIZ REXHEP BENA	2876	139/15	ARË	6328	1645	222	365,190.0						365,190.0	
61	HETEM RAMIS BENO	2876	139/13	ARË	1898	495	222	109,890.0						109,890.0	
62	NAZMI REXHEP BENA	2876	139/14	ARË	2770	653	222	144,966.0						144,966.0	
63	SHTET	2876	139/17	ARË	3625	800	0	0.0						0.0	
64	GANI HAMIT SUBASHI	2876	139/20	ARË	7697	1549	222	343,878.0						343,878.0	
65	MEKHIT SUBASHI	2876	139/22	ARË	3447	598	222	132,756.0						132,756.0	
66	BASHKIM ELMAS SUBASHI	2876	139/26	ARË	7808	1421	222	315,462.0						315,462.0	



67	GANI RIZA KURTI	2876	139/30	ARË	1246	220	222	48,840.0							48,840.0	Ne seksionin E të kartelës ka shënimin: me shkresën nr. 1135 akti, datë 12.2.2019 regjistrohet padia gjyq. Zamira Vyshka
68	KALEM RAKIP SUBASHI	2876	139/32	ARË	1922	341	222	75,702.0							75,702.0	
69	KADRI RAKIP SUBASHI	2876	139/33	ARË	1928	418	222	92,796.0							92,796.0	
70	SHTET	2876	139/1	LEDH	2803	891	0	0.0							0.0	
71	SHTET	2876	139/2	KANAL	1228	305	0	0.0							0.0	
72	SHTET	2876	139/56	RRUGË	531	125	0	0.0							0.0	
73	XHEMAL QAZIM KARAJ	2876	139/19	ARË	2760	579	222	128,538.0							128,538.0	
74	BAJRAM QAZIM KARAJ	2876	139/18	ARË	1326	495	222	109,890.0							109,890.0	
75	MUHAMREK QEMAL SUBASHI	2876	139/3	ARË	510	471	222	104,562.0							104,562.0	
76	HASAN BAJRAM HASALLA	2876	139/6	ARË	2626	947	222	210,234.0							210,234.0	
77	HASAN BAJRAM HASALLA	2876	139/7	ARË	1290	455	222	101,010.0							101,010.0	Sip. është dhënë në pasurinë 139/6 vol. 1; f. 48
78	HASAN BAJRAM ASALLA NEZIR HASAN ASALLA SHYQYRI HASAN ASALLA	2876	139/8	ARË	8184	2644	222	586,968.0							586,968.0	Akti 23 (4305 m ²); akti 24 (4830 m ²); akti 25 (2539 m ²)
79	HAMIT ABAS ÇILI	2876	139/53	ARË	9392	2262	222	502,164.0							502,164.0	
80	KUJTIM HAMIT ÇILI	2876	139/52	ARË	3522	1063	222	235,986.0							235,986.0	Te përshkrimi i veçantë ka shënimin: AKTI 3522+900
81	SEFER ALI HIMÇI	2876	139/45	ARË	2348	562	222	124,764.0							124,764.0	
82	SEFER ALI HIMÇI	2876	139/46	ARË	540	435	222	96,570.0							96,570.0	
83	NAZMI XHEVIT SKURA	2876	139/50	ARË	4422	1169	222	259,518.0							259,518.0	
84	RAMAZAN RESHIT SKURA	2876	139/51	ARË	2000	1275	222	283,050.0							283,050.0	
85	FADIL RESHIT SKURA	2876	139/41	ARË	6349	1201	222	266,622.0							266,622.0	
86	ISMAIL QAZIM KATESHI	2876	139/44	ARË	5283	1149	222	255,078.0							255,078.0	
87	HYSEN SEFER HIMÇI	2876	139/48	ARË	4696	757	222	168,054.0							168,054.0	
88	LJMAN ZENEL ÇELA	2876	139/47	ARË	9618	1473	222	327,006.0							327,006.0	
89	HAVA KATESHI	2876	139/43	ARË	4120	846	222	187,812.0							187,812.0	
90	KADRI QAZIM KATESHI	2876	139/42	ARË	2931	910	222	202,020.0							202,020.0	
91	ARIF JONUZ SUBASHI BUJAR ARIF SUBASHI	2876	31/44	ARË	6761	2064	222	458,208.0							458,208.0	Te përshkrimi i veçantë ka shënimin: AKTI 27 (2873 m ²); AKTI 28 (3652 m ²); Me ref. 0124 saktësohet sipërfaqja me nr. 6764 m ² pas rregullimit të bllokut.
92	RAMAZAN ARIF SUBASHI	2876	31/42	ARË	2557	988	222	219,336.0							219,336.0	Te përshkrimi i veçantë ka shënimin: me ref. 0424 saktësohet sipërfaqja me nr. 2557 m ² .
93	BEQIR SHERIF DYBELI	2876	31/38	ARË	4055	1404	222	311,688.0							311,688.0	Te përshkrimi i veçantë ka shënimin: me ref. 0424 saktësohet sipërfaqja, pasi është rregulluar blloku 31
94	SHTET	2876	139/49	ARË	4696	893	222	198,246.0							198,246.0	
95	ISMAIL IBRAHIM SENJA RYZHIDI SENJA	2876	31/39	ARË	5860	1375	222	305,250.0							305,250.0	Te përshkrimi i veçantë ka shënimin: AKTI 33 (4280 m ²); AKTI 37 (1580 m ²); me ref. 0424 saktësohet sipërfaqja me nr. 5860 m ² pas rregullimit të bllokut.
96	PETRIT ISMAIL GJELI	2876	31/37	ARË	4608	1420	222	315,240.0							315,240.0	
97	RAMAZAN DEMIR KATESHI	2876	31/36	ARË	7033	2106	222	467,532.0							467,532.0	Te përshkrimi i veçantë ka shënimin: me ref. 0424 saktësohet sipërfaqja me



															nr. 7033 m ² pas rregullimit të bllokut.
98	FATMIR IBRAHIM BAJRAMI SERVETE TAHIR BAJRAMI	2876	31/35	ARË	2670	887	222	196,914.0						196,914.0	Te përshkrimi i veçantë ka shënimin: me ref. 0424 saktësohet sipërfaqja me nr. 2670 m ² pas rregullimit të bllokut.
99	ASAN HAXHI LATA	2876	31/31	ARË	2032	582	222	129,204.0						129,204.0	Te përshkrimi i veçantë ka shënimin: sip. janë dhënë në pas. 20/3 vol. 1, f. 106; me ref. 0424 saktësohet sipërfaqja me nr. 2032 m ² pas rregullimit të bllokut 31. Në seksionin D të kartelës ka shënimin: mbi këtë pasuri ndodhet ndërtesa nr. 31/31/1-ND v. 5, f. 57
100	EDUART HASAN LATA	2876	31/32	ARË	1830	551	222	122,322.0						122,322.0	Te përshkrimi i veçantë ka shënimin: me ref. 0424 saktësohet sipërfaqja me nr. 1830 m ² pas rregullimit të bllokut.
101	ALI MUSA SEJDINI	2876	31/30	ARË	2575	832	222	184,704.0						184,704.0	Te përshkrimi i veçantë ka shënimin: me ref. 0424 saktësohet sipërfaqja me nr. 2575 m ² pas rregullimit të bllokut. Me ref. 0458 dhe mbas rregullimit të bllokut dhe depozitimit të dosjes lëshohet certifikata e pronësisë.
102	MET MURAT KASA	2876	31/27	ARË	3716	2812	222	624,264.0						624,264.0	Te përshkrimi i veçantë ka shënimin: me ref. 0424 saktësohet sipërfaqja me nr. 3716 m ² pas rregullimit të bllokut.
103	RESHIT LIÇI	2876	31/33	ARË	1800	578	222	128,316.0						128,316.0	Te përshkrimi i veçantë ka shënimin: me ref. 0424 saktësohet sipërfaqja me nr. 1800 m ² pas rregullimit të bllokut.
104	LUTFI ISMAIL GJELI	2876	31/34	ARË	3950	1194	222	265,068.0						265,068.0	Te përshkrimi i veçantë ka shënimin: me ref. 0424 saktësohet sipërfaqja me nr. 3950 m ² pas rregullimit të bllokut.
105	ZYBER VELI SUBASHI	2876	139/37	ARË	2256	245	222	54,390.0						54,390.0	
106	ZYBER VELI SUBASHI	2876	139/39	ARË	5720	774	222	171,828.0						171,828.0	
107	SHTET	2876	31/28	KANAL	500	194	222	43,068.0						43,068.0	Te përshkrimi i veçantë ka shënimin: me ref. 0424 saktësohet sipërfaqja me nr. 500 m ² pas rregullimit të bllokut 31.
108	ISUF HASAN KARAJ	2876	52/1	ARË	4215	338	222	75,036.0						75,036.0	Te përshkrimi i veçantë ka shënimin: me ref. 0423 saktësohet sipërfaqja me nr. 4215 m ² pas rregullimit të bllokut 52.
109	ISUF HASAN KARAJ	2876	52/2	ARË	2934	532	222	118,104.0						118,104.0	Te përshkrimi i veçantë ka shënimin: me ref. 0423 saktësohet sipërfaqja me



															nr. 2934 m ² pas rregullimit të bllokut 52.
110	NEZIR OSMAN KULLA	2876	52/3	ARË	2467	618	222	137,196.0						137,196.0	Te përshkrimi i veçantë ka shënimin: me ref. 0423 saktësohet sipërfaqja me nr. 2467 m ² pas rregullimit të bllokut 52.
111	MYZYR SKENDERI	2876	52/5	ARË	2855	584	222	129,648.0						129,648.0	Te përshkrimi i veçantë ka shënimin: me ref. 0423 saktësohet sipërfaqja me nr. 2855 m ² pas rregullimit të bllokut.
112	NDRIÇIM QERIM KARAJ	2876	52/4	ARË	1970	629	222	139,638.0						139,638.0	Te përshkrimi i veçantë ka shënimin: me ref. 0423 saktësohet sipërfaqja me nr. 1970 m ² pas rregullimit të bllokut 52.
113	XHEVAHIR ALI GJEVORI ISUF ALI GJEVORI	2876	52/7	ARË	2070	178	222	39,516.0						39,516.0	Te përshkrimi i veçantë ka shënimin: me ref. 0423 saktësohet sipërfaqja me nr. 2070 m ² pas rregullimit të bllokut 52.
114	HYDAJET SABRI CANI	3702	1//1	ARË	1151	378	222	83,916.0						83,916.0	
115	SABRI RAMAZAN CANI	3702	1//2	ARË	1039	147	222	32,634.0						32,634.0	
116	BEDRIJE OSMAN CANI	3702	1//4	ARË	3650	3381	222	750,582.0						750,582.0	
	DONIKA DYLAVER ÇAUSHAJ														
	DYLAVER ARIF CANI														
	GËZIM DYLAVER CANI														
	JETMIRA DYLAVER PISHA														
	LINDITA DYLAVER PIRRA														
	SHPËTIM DYLAVER CANI														
	VALBONA DYLAVER HOXHIA														
117	XHEVIT RIZA CANI	3702	1//5	ARË	1850	1404	222	311,688.0						311,688.0	
118	KUJTIM RIZA CANI	3702	1//6	ARË	2140	1261	222	279,942.0						279,942.0	
119	SHTET	3702	138//	RRUGË	7099	218	0	0.0						0.0	
120	SHTET	3702	550/2	LUMË	145998	5713	0	0.0						0.0	
121	SHTET	3702	540/1	RRUGË	16205	3390	0	0.0						0.0	
122	SHTET	3702	100/4	RRUGË	1031	1205	0	0.0						0.0	
123	SHTET	3702	100/1	ARË	3412	1679	0	0.0						0.0	
124	SHTET	3702	150/1	RRUGË	6916	90	0	0.0						0.0	
125	SHTET	3702	100/2	KANAL	1673	496	0	0.0						0.0	
126	SHTET	3702	550/1	LUMË	42054	9445	0	0.0						0.0	
127	LUZE MERSIN MEKSHI	3702	18/2	ARË	1000	117	222	25,974.0						25,974.0	
128	DALIP BAFIJAR BULLARI	3702	18/6	ARË	1880	294	222	65,268.0						65,268.0	
129	DALIP BAFIJAR BULLARI	3702	20/15	ARË	1620	464	222	103,008.0						103,008.0	Me ref. 0264 saktësohet sipërfaqja ne 1620 m ² pas rregullimit të bllokut
130	BAFIJAR ABAZ BULLARI	3702	20/14	ARË	2500	530	222	117,660.0						117,660.0	Me ref. 0264 saktësohet sipërfaqja ne 2500 m ² pas rregullimit të bllokut
131	SKENDER MUSA BULLARI	3702	20/13	ARË	1636	527	222	116,994.0						116,994.0	Me ref. 0264 saktësohet sipërfaqja ne 1636 m ² pas rregullimit të bllokut
132	MUSTAFA ABAS BULLARI	3702	20/12	ARË	6050	1962	222	435,564.0						435,564.0	Me ref. 0264 saktësohet sipërfaqja ne 6050 m ² pas rregullimit të bllokut
	SAMI MUSTAFA BULLARI														
	SKENDER MUSTAFA BULLARI														
	SHPETIME MUSTAFA BULLARI														



	LIRI KAMER BULLARI														
	FLUTURIM SAMI BULLARI														
	RUZHDIJE DALIP BULLARI														
	ALEKSANDËR SKËNDER BULLARI														
	LEONARD SAMI BULLARI														
133	SHEFQET GANI BULLARI	3702	20/10	ARË	3340	1121	222	248,862.0						248,862.0	Me dok. me ref. 0141 është bërë saktësimi i sipërfaqes dhe i kufirit për këtë pasuri; me ref. 0264 rregullohet blloku dhe sip. nuk ndryshon
	HANIFE RAMAZAN BULLARI														
	MANJOLA SHEFQET BULLARI														
	EDMIR SHEFQET BULLARI														
134	SABIT GANI BULLARI	3702	20/11	ARË	2850	694	222	154,068.0						154,068.0	Me dok. me ref. 0181 është bërë saktësimi i sipërfaqes dhe i kufirit; Me ref. 0264 rregullohet blloku dhe sip. nuk ndryshon.
135	ABEDIN MEHMET KOCIU	3702	20/1	ARË	5700	3009	222	667,998.0						667,998.0	Me ref. 0264 saktësohet sipërfaqja pas rregullimit të bllokut 20 dhe korrigjohet numri i volumit të KKP-së.
136	RUZHDI HYSEN BULLARI	3702	20/2	ARË	6565	2294	222	509,268.0						509,268.0	Me ref. 0264 është përmirësuar, përditësuar blloku dhe sipërfaqja nuk ka ndryshuar.
137	ALI HYSEN BULLARI	3702	20/3	ARË	4920	2495	222	553,890.0						553,890.0	Me ref. 0264 saktësohet sipërfaqja në 4920 m ² pas rregullimit të bllokut
138	ILJAS DALIP BULLARI														
	DRITA RIZA BULLARI														
	OLSI ILJAS BULLARI														
	ARANIT ILJAS BULLARI														
	HALIT DALIP BULLARI														
	FLAMUR DALIP BULLARI														
	RABIJE DALIP XHAKOJ														
	GUSHI DALIP BULLARI	3702	20/7	ARË	4250	2325	222	516,150.0						516,150.0	Me ref. 0264 saktësohet sipërfaqja në 4250 m ² pas rregullimit të bllokut
139	VEIZ ABDYL META	3702	20/5	ARË	4139	2001	222	444,222.0						444,222.0	Me ref. 0264 saktësohet sipërfaqja në 4139 m ² pas rregullimit të bllokut
140	PETRIT SHAHIN MEKSHI	3702	18/3	ARË	1220	83	222	18,426.0						18,426.0	
141	RESHIT MESUT CANI	3702	18/8	ARË	1780	166	222	36,852.0						36,852.0	
142	HALIT HASAN TUFJA	3702	18/10	ARË	3297	219	222	48,618.0						48,618.0	
143	ISLAM HASAN BULLARI	3702	18/11	ARË	6592	58	222	12,876.0						12,876.0	
144	DERVISH RAMAZAN BULLARI RAMIZ RAMAZAN BULLARI	3702	18/9	ARË	4342	287	222	63,714.0						63,714.0	
145	OSMAN XHEMAL CANI	3702	20/17/1	ARË	6900	1598	222	354,756.0						354,756.0	Kjo pasuri krijohet nga ndarja e pasurisë 20/17, v. 1, f. 232; me ref. 0264 rregullohet blloku kadastral dhe sip. nuk ndryshon
146	XHEVDET ELMAN CANI	3702	19/2	ARË	7342.3	3967	222	880,674.0						880,674.0	



147	KUJTIM RIZA CANI	3702	19/3	ARË	5710	3092	222	686,424.0							686,424.0	
148	SHYQYRI ELMMAZ CANI	3702	19/4	ARË	2600	729	222	161,838.0							161,838.0	
149	XHEVIT RIZA CANI	3702	19/5	ARË	7376	3250	222	721,500.0							721,500.0	
150	BASHKIM REXHEP LIÇI	3702	19/6	ARË	6761	2867	222	636,474.0							636,474.0	
151	DYLAVER ARIF CANI BEDRIJE OSMAN CANI JETMIRA DYLAVER CANI VALBONA DYLAVER CANI LINDITA DYLAVER CANI GËZIM DYLAVER CANI SHPËTIM DYLAVER CANI DONIKA DYLAVER CANI NIGJARE ARIF ZEKTHI SHAHE ARIF LIÇI DUDI ARIF KRECI HYSMETE ARIF KURTI LUMTURI ARIF LEKTHI	3702	19/7	ARË	9020	574	222	127,428.0							127,428.0	Me ref. nr. 0301 bëhet saktësimi i sip. Nga 10099 m ² në 9020, si dhe bëhet saktësimi i kufirit të pasurisë sipas planit të rilevimit.
152	SABRI RAMAZAN CANI	3702	19/9	ARË	3660	1508	222	334,776.0							334,776.0	
153	RAMAZAN RAMAZAN CANI	3702	19/8	ARË	6530	3961	222	879,342.0							879,342.0	
154	RESHAT SABRI CANI EMIN SABRI CANI	3702	19/10	ARË	6390	1504	222	333,888.0							333,888.0	Akti 99 (4130 m ²); akti 100 (2260 m ²)
155	HYDAJET SABRI CANI	3702	19/11	ARË	3200	1661	222	368,742.0							368,742.0	
156	SHKELQIM PETRIT CANI	3702	19/12	ARË	4470	1871	222	415,362.0							415,362.0	
157	BASHKIM REXHEP LIÇI	3702	4//12	ARË	2286	158	222	35,076.0							35,076.0	
158	SABRI RAMAZAN CANI	3702	4//13	ARË	1000	324	222	71,928.0							71,928.0	
159	JEMIN SABRI CANI	3702	4//14	ARË	1840	716	222	158,952.0							158,952.0	
160	HANÇE MISIR CANI SHKELQIM PETRIT CANI ADRIANA PETRIT (CANI) ZOGU BLERTA PETRIT TABAKU (CANI) MANUSHAQE PETRIT LLESHI (CANI) XHIEMILE HASAN CANI JONIDA SHKELQIM CANI ADRIATIK SHKELQIM CANI ARJAN PETRIT CANI FATMIRE PETRIT CANI	3702	4//15	ARË	3920	59	222	13,098.0							13,098.0	
161	SHTET	1085	21/9	ARË	1493	428	0	0.0							0.0	Okupuar nga Astrit Ymer Kullolli
162	SARE SEIT KULLOLLI YMER IBRAHIM KULLOLLI	1085	21/7	ARË	1800	1074	222	238,428.0							238,428.0	Kanali ujit zi 306
163	ALBAN HAZIZ DURAKU ANA HAZIZ DURAKU FATIME MUSA DURAKU HAZIZ HAMIT DURAKU NEXHMIJE SHERIF DURAKU	1085	21/5	ARË	2800	1484	222	329,448.0							329,448.0	Kanali ujit zi 257
164	SHTET	1085	21/32	KANAL	7686	476	0	0.0							0.0	
165	SHTET	1085	21/31	KANAL	665	217	0	0.0							0.0	
166	SHTET	1085	17/1	ARË	3476	1157	0	0.0							0.0	Okupuar nga Servet Qani
167	HAVA SHAHIN DURAKU RAMAZAN HAZIZ DURAKU	1085	21/3	ARË	3600	2357	222	523,254.0							523,254.0	Kanali ujit zi 265
168	BARDHYL IMER TEODORI IMER HAXHI TEODORI MITE IMER TEODORI MYRVET IMER TEODORI SHADIJE TAIP TEODORI TUFIJE IMER TEODORI VLADIMIR IMER TEODORI	1085	17/10	ARË	2000	1651	222	366,522.0							366,522.0	Kanali ujit zi 433



169	SHTET	1085	21/29	ARË	1449	672	0	0.0						0.0	Okupuar nga Pellumb Kosta
170	SHTET	1085	21/27	ARË	1563	754	0	0.0						0.0	Okupuar nga Shaban Pellumb Kosta
171	SHTET	1085	21/26	ARË	2757	2191	0	0.0						0.0	Okupuar nga Shebet Kosta
172	SHTET	1085	17/23	KANAL	1357	288	0	0.0						0.0	
173	SHTET	1085	21/24	ARË	2333	1333	0	0.0						0.0	Okupuar nga Veli Karaj
174	SHTET	1085	21/21	ARË	2796	2201	0	0.0						0.0	Okupuar nga Besnik Arshin Karaj
175	SHTET	1085	21/19	ARË	3086	1656	0	0.0						0.0	Okupuar nga Jonuz Karaj
176	ALMA SERVET QEVANI	1085	17/4	ARË	5300	987	222	219,114.0						219,114.0	Ish-Rep. Ushtarak 397
	ARDJAN SERVET QEVANI														
	DHURATA SERVET QEVANI														
	FERDINAND SERVET QEVANI														
	MEREME SEFRET QEVANI														
177	SERVET SHABAN QEVANI	1085	17/6	ARË	2400	838	222	186,036.0						186,036.0	Ish-Rep. Ushtarak K 430
	ALTIN SABRI QEVANI														
	BEDRIJE YMER QEVANI														
	MATILDA SABRI QEVANI														
178	SABRI SHABAN QEVANI	1085	17/7	ARË	931	352	0	0.0						0.0	Okupuar nga Sabri Qevani
	FADIL SHABAN QEVANI														
	KLEVIS FADIL QEVANI														
179	LEJLA HASAN QEVANI	1085	17/8	ARË	2300	893	222	198,246.0						198,246.0	Rep. Ushtarak 250
180	SHTET	1085	17/9	ARË	6491	2802	0	0.0						0.0	Okupuar nga Fadil Shaban Qevani
181	BRUNILDA MEVLAN KASA	1085	19/21	ARË	7300	1115	222	247,530.0						247,530.0	Gropa Siliazhi 245
	ELIDA MEVLAN KASA														
	KLEMENT MEVLAN KASA														
	LORETA MEVLAN KASA														
	OLTJON MEVLAN KASA														
	RUDINA MEVLAN KASA														
	SHIPRESA MUSTAFA KASA														
182	MEVLAN ALI KASA	1085	19/22	ARË	3069	1774	0	0.0						0.0	Okupuar nga Mevlan Ali Kasa
183	ASTRIT YMER KULLOLLI	1085	21/10	ARË	3000	1936	222	429,792.0						429,792.0	KANALI UJIT ZI 217
	ERSIDA ASTRIT KULLOLLI														
	ERVIN ASTRIT KULLOLLI														
	VALENTINA NESHDET KULLOLLI														
184	SHTET	1085	21/11	ARË	1889	1111	0	0.0						0.0	OKUPUAR NGA DERVISH KULLOLLI
185	ARBEN DERVISH KULLOLLI	1085	21/12	ARË	2500	1017	222	225,774.0						225,774.0	Kanali ujit zi 302
	DERVISH YMER KULLOLLI														
	FIZE ALI KULLOLLI														
	FJORENTINA DERVISH KULLOLLI														
	MARJO DERVISH KULLOLLI														
186	SHTET	1085	21/13	ARË	1398	1364	0	0.0						0.0	Okupuar nga Rifat Hamit Duraku
187	RIFAT HAMIT DURAKU	1085	21/14	ARË	2200	413	222	91,686.0						91,686.0	
188	SHTET	1085	21/15	ARË	3018	2421	0	0.0						0.0	Okupuar nga Bilal Hamit Duraku



189	SHTET	1085	21/17	ARË	1517	1252	0	0.0							0.0	Okupuar nga Naim Jonuz Karaj
190	SHTET	3764	52/26/7	PYLL	51475.8	8123	0	0.0							0.0	
191	DASHAMIR QEMAL MOLI	1258	20/1/11-ND	NDËRTESE								66.7	32695	2180756.5	2,180,756.50	
192	DASHAMIR QEMAL MOLI	1258	20/1/54	TRUALL	200.1				200.1	1840	368184				368,184.00	
193	EN-SAL	3764	52/26/6	TRUALL	380.1				380.1	284	107948.4	135.8	32695	4439981	4,547,929.40	
194	GENCI CANI	3702	1/5/1-ND	NDËRTESE								271.8	32695	8886501	8,886,501.00	
	NERTILA CANI															
195	HIQMET HYSEN LENA	3965	597/2-ND	NDËRTESE								90.3	32695	2952358.5	2,952,358.50	
SHUMA PARAPRAKE															46,482,821.4	

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2025

Adresa: Rr. “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 144 lekë

